

INTERVISTË ME AGIM GJAKOVËN

Prishtinë | Data: 5 dhe 6, mars 2024

Kohëzgjatja: 233 minuta

Të pranishëm:

- Agim Gjakova (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Agim, nëse mundeni me u prezantu fillimisht, vitin e lindjes, diçka për familjen edhe prejardhjen e juaj?

Agim Gjakova: Une jam Agim Gjakova, me origjinë nga Gjakova me prind e me krejt. I lindur në vitin 1935 me 11 korrik.

Anita Susuri: Çfarë familje jeni rritë?

Agim Gjakova: Familja ime ka qenë familje arsimtare. Ka ni histori t'vëçantë për t'cilën do të përshkruaj por para se të them këtë du të them, meqë doni ni pjesë nga jeta ime. Jeta ime ka qëndruar në ruajtjen e integritetit tim plotësisht deri me ditën e sotme në këtë moshë. Kur unë nuk kam pranuar t'jem i varur nga askush por nuk kam tentuar të jetë edhe dikush prej meje i varur. Jam rritur në Gjakovë ku kam filluar klasën e parë në vitin 1941 dhe pastaj kam mbaruar shkollën fillore në Gjakovë gjatë Luftës së Dytë Botërore, pra '41-'45, '44. Lufta përfundoj në '45-ten po Gjakova u shkurua në '44-ten.

Familja ime... im atë ka pasur edhe tre vëllezër të cilët brenda tri vite e gjysë të gjithë u eliminuan. Vllau i parë ka vdekur në vitin 1942, im atë ka vdekur në vitin 1943. Ka qenë kryetar i këshillit të parë nacional çlirimtar gjatë luftës, i themeluar në dimrin e vitit 1941 në Gjakovë. Ku ende në asni trevë shqiptare nuk kishin filluar të formohen këshillat nacional çlirimtar. U arrestu nga fashistët italian. U bë ni demonstratë e fuqishme ku morën pjesë i gjithë populli dhe u mbyllën të gjitha dyqanet, nuk punohej pazari, nuk punohej asgjë, për lirin e tij.

Kjo demonstratë u shtyp me dhunë. U vra një nga demonstruesit në radhët e para, u plagosën ca të tjerë. U rrahën kë e zunë e kë nuk e zunë italianët si demonstrues, u hodh edhe ushtria. U detyruan ta lëshojnë. Po meqenëse ekishin torturuar dhe mbajtur keq në burg dhe im atë ka qenë jo shumë... pra ka qenë shëndet ligë, vdiq në shtëpi. Nëna ime vazhdoi mësuesinë. Se im atë, duhet t'themi, ka dalë me ni mollë n'xhep në vitin 1919 në qetë me Bajram Currin. Ka shkuar në Shqipëri për t'krijuar, për t'formuar shtetin shqiptarë n'atë kohë.

Ka punuar atje msus. Prandaj edhe unë kam lindur në Kavajë. Ka punuar në Shqipëri bashkë me nënën. Të dy kanë qenë msues. Në '41-shin kur Kosova ju bashku atij shtetit shqiptarë që ishte atëherë nën Italinë fashiste u kthym edhe ne në Kosovë. Pra, siç thashë, nëna vazhdoj mësuesinë. Xhaxhai im Haki Taha edhe ky msus. Njëkohësisht në vitin 1945 me 8 mars m'duket, 8 shkurt, 8 mars, 12 mars, 13 mars, nuk m'kujtohet mirë data, vrau Milladin Popoviçin, sekretarin e parë të Komitetit të Partisë Komuniste Jugosllave në atë kohë. Për arsye se të gjithë këta nacionalista shqiptarë ishin që Kosova të bashkohet me Shqipërinë pas luftës. E kjo nuk ndodhi. Ky ishte përgjegjës. Sidomos për masakrat që u bonë në Kosovë në vitin '44-'45 ku u masakruan mbi 35 mijë, 40 mijë shqiptarë domethanë.

Anita Susuri: A dini ndonjë detaj ma shumë rreth kësaj vrasje? A dini ndonjë detaj ma shumë lidhur me vrasjen e Milladin Popoviçit?

Agim Gjakova: Po Enver Hoxha që e kishte mik dhe që t'mos dilte gjithë maskrallëku i tij për formimin e partisë e tjera e tjera që ma vonë edhe kanë dalur n'shesh edhe ata që kanë mbetur gjallë. Tha që, "Këta të dy i ka vra UDB-ja", që nuk është e vërtetë. Përveç faktit të njerëzve që kanë mbetur gjallë që i kanë njohur dhe kanë mbetur shok në atë kohë, do përmend vetëm dy raste. Në vitin '93 erdhi Luan Gashi, i biri i Ahmet Gashit. Ahmet Gashi ka qenë drejtor i gjimnazit të Prishtinës gjatë Luftës së Dytë Botërore '41-'44.

U takuam por më thriti ma vonë se ishin kallaballëk njerëz. Më thriti më vonë që t'më kumtonte. "Të gjithë çka thonë për vrasjen e Milladinit nga Haki Taha, axhi yt", tha, "janë prralla. Ne", tha, "kemi qenë shokë. Ai e mori përsipër këtë detyrë vet sepse nuk dihet a do t'dilte i gjallë, dhe s'doli i gjallë natyrisht, dhe ne ishim nja 12-15 veta po pritshim në Gërmë", tha, "që ta kryente atentatin dhe t'bashkohej me ne dhe t'largoheshim nga Kosova. Ai", tha, "e kreu u diktua. Për t'mos ra n'dur të armiqëve", tha, "vrau vetën". Këta ma ka diktuar edhe Hysen Tërpeza i cili ka qenë n'atë grup. Domethanë këta dy.

Është edhe një personazh tjetër, një person tjetër Vula nga Gjakova i cili ka qenë i burgosur ktu edhe atje i burgosur edhe në Shqipëri. Edhe ai e ka puhuar atë që Hakiu ka vra. Versioni zyrtar dihet, vrasjen e ka ba. Ka disa supozime që ashtu... pas shkapërderdhjes së Jugosllavisë malazezët kanë pasur kontradikta edhe me Serbinë. Jo krahu që është pro serb, krahu që është malazez. Po t'kishte ndodhë që do të kishte vra UDBA kanë dalë shumë e shumë faktorë për çka ka kryer UDBA. Për këtë nuk është ndjerë fare për arsye se versioni zyrtar është i tillë dhe vërtetë është kjo.

Anita Susuri: Deshta me u kthi pak te familja e ngushtë e ju, te...

Agim Gjakova: Familja jeme kanë qenë prej katër vetash. Baba dhe nana të dy msues. Motra ma e madhe se unë edhe ajo mbaroi shkollat dhe ka punuar si lektore në ndërmarrjen e botimeve Rilindja, në dyqanin e librave derisa ka dalë n'pension. Është martuar me një punonjës ktu shqiptarë i Kosovës që ka punuar kryesisht në turizëm. Ni periudhë ka qenë edhe drejtor turizmi. Kjo ka qenë familja ime.

Anita Susuri: Nana ju j çfarë prejardhje ka? Çfarë familjes i ka taku?

Agim Gjakova: Nana ime ka, është, fëmija i tetë nga tetë fmijë që ka pasë familja Shehdula. I ati ka qenë sheh po ka qenë sheh edhe atdhetar po edhe njeri me shkollë, jo fetar i ndrydhur. Nana m'thoshte, "Kur merrja me bo ndonjë punë se isha ma e vogël thoshte, 'Ik, ik ti merr librin shko atje'". Do t'thotë n'atë kohë t'i thonte ni fetar, "Shko merr librin e mëso", ishte shumë... nana mbaroi ni shkollë protore në Gjakovë në vitin '10 dhe ka qenë njëkohësisht mësuesja e parë muslimane në Kosovë. Në atë kohë megjithëse e re, shumë e re, 15-16 vjeçe sa ka qenë, u bë mësuese. Mësuese vullnetare jo me rrogë e kshtu. Që i msonte pastaj të tjerët. Në Shqipëri pastaj u emëru mësuese.

Anita Susuri: Si quhet ajo?

Agim Gjakova: Emine, Emine Shehdula ose Gjakova. Baba quhet Demush. E ke ndoshta në libër, mund t'i kem thanë atëherë.

Anita Susuri: Po.

Agim Gjakova: Kjo ishte pak a shumë për familjen. E tashti du t'them ktu, kjo ka qenë familje e madhe katër vllazën edhe katër motra. Vllau i tretë i qujtun Musa Shehdula ka qenë jurist. Kur është ngritur flamuri në Vlorë në vitin 1928, nëntor me 4 apo me 2 dhjetor ai e ka ngritë flamurin në Gjakovë. Kur filloj lufta ballkanike dhe në Gjakovë hyjnë malazezët, domethonë Jugosllavia atëherë, ai u detyru me ikë dhe u largu për Shqipëri. Kurse vllai i katërt Hajdar Shehdula që njihet edhe si Hajdar Berisha ka qenë mësues në fillim në Pejë e tjera. Edhe të dy vllaznit e tjerë i madhi ka mbaruar medresenë e Shkupit, ka qenë mësues diku anej nga Gjilani, Vitia, nuk e di dikund ka dhanë mësim. Ka marrë pjesë edhe në kryengritjen e dhjetës kur është bënë në Kosovë në atë kohë, 10-12.

Anita Susuri: Familja ju j, familja Gjakova, a ka qenë gjithmonë Gjakova apo keni ndonjë prejardhje?

Agim Gjakova: Jo jo gjithmonë në Gjakovë. Vetëm lëvizja që është bërë në Shqipëri dhe Gjakovë.

Anita Susuri: Po m'intereson pak fëmijëria ju j se është ni kohë shumë e randë domethanë, është Lufta e Dytë Botërore...

Agim Gjakova: Po, ndëgjo, në fillim italianët nuk ngacmuan, nuk u përzien në ekonomi. Gjithë prodhimet e Kosovës mbetën në Kosovë se s'kishin edhe ku t'shkonin se s'kishte çarkullim, lufta ishte në këmbë, kudo eksportoheshin. Përveç në Shqipëri kuptohet që s'kish më kufi e tjera që vinin prodhimet e tjera. Fëmijëria ime nuk ka qenë e vështirë për arsye se gjendja ekonomike e prindërve ka qenë e mirë. Të dy mësues me rroga dhe rrogat nuk kanë qenë të kqija, domethënë.

Por vështirësia vjen më vonë pas '44-'45-tes kur, siç thashë, u bo atentati dhe xhaxhai vrau Milladin Popoviçin, Fadil Hoxha i cili njihej se ishte mësues. Baba ishte kryetar i parë i Këshilli Nacional Çlirimtar dhe drejtor i shkollës në Gjakovë dhe drejtor didaktik i tri nënprefekturave. Sepse Ministria e Arsimit e asaj kohe e kishte ndarë Kosovën nga tri nënprefektura dhe ky drejtori didaktik quhej ishte në rolin e inspektorit të arsimit me inspektu shkollat dhe këto tri nënprefektura. Kshtuqë e kom fjalën që unë kom shku dy-tre herë me babën nëpër fshatra për t'parë.

Pas '45-tes pastaj filloj vështirësia. E para vështirësia ekonomike. Nuk e di a kanë theksu a jo të tjerët por në vitin 1944, '45, '46 sidomos '45-ten, mblodhën krejt drithin në Kosovë dhe miell, gjithçka çka kishte. Nuk lanë asni gja. Madje edhe ato magjet, se tashti s'ka, ku gatuhej dhe ku sitej mielli, ato pluhuri i miellit mblidhej rreth e përçark, edhe atë e hoqën që atë nuk e ka hangër askush, nuk e ka gatu kush. Po ka qenë ni krizë e jashtëzakonshme e bukës.

Pra, ka qenë popullësia përballë urisë, përballë urisë. Shkoj ni kile misër nëse e gjeje diku kontrabandë se po të kapnin të burgoseshin. Shkonte gati ni e treta e rrogës e një punonjësi, ni kile misër. Njerëzit kanë hangër rranjë, kanë hangër gjethe, kanë hangër t'përzine gjithçka çka kanë mundur. Për të dalë në verën e pranverë të atij dimri.

Anita Susuri: A keni pasë ju pasuri që ju kanë konfisku?

Agim Gjakova: Jo, s'kemi pasë pasuri. S'kemi qenë familje e pasur. Kemi qenë familje normale. Familje nëpunësi, familje rrogtarësh, me rroga domethanë. Jo me ndonjë asi... a baba ka qenë i njohur në të gjithë Gjakovën edhe si kryetar e tjera. Dhe varrimi i tij kur është bërë është mbyllë totalisht gjithë pazari, gjithë dyqanet e krejt popullësia kanë qenë jo me qindra po me mijëra vet kanë marrë pjesë n'varrimin e tij.

Anita Susuri: A ju kujtohen juve ato detajet e...

Agim Gjakova: Po unë isha tetë vjeç, i ri. Kufoma siç është vendosur n'oborr në atë lartë. Pastaj u nisën kufoma. M'ka marrë djali i tezës që ishte ma i madh përdore. Se e kishin porositë ata që t'mos m'linin vetëm, a po kupton? Dhe kemi shku. Mesa di unë, në vorrim të tij ka folur Selman Riza, Ibrahim Fehmiu dhe Gjergj Martini. Gjergj Martinin e kam pasur mësues të klasës së parë fillore. Mu nuk më dërguan n'fillim gjashtë vjeçaren n'klasë t'parë se thanë le t'forcohet pak ky. Tash nuk e di a ka qenë viti i ri asi, po unë makinën e shkrimit moti i kisha mësuar të gjitha shkronja.

Më mori në prehër duke m'pyetur unë po i tregoj shkronjat. Po i thotë nënës time, "Zonja Emine", tha, "po ta marr Agimin se na ende nuk i kemi mësuar gjysmën e shkronjave ky i dika t'gjitha". Edhe më mori në klasë t'parë dhe më uli në bankën e parë. Kishin mbrri te shkronja "L" duhej ta shkruante shkronjën "L". Dora ime s'kishte kapur laps, kalem kurgjo me dorë. Nuk kishte burrë nane që dora ime

ta shkruante shkronjën “L”. Nga sikleti më mërtheu vaji erdhi ai, mu dorën n’kry, m’i bëri nja dy grrëmça më tha, “Mbushe fletorën”. Nja dy-tre ditë pastaj u forcova.

Kështu ishte ajo që... dhe si t’them vështirësia pastaj filloj sidomos kur... tash ne fillim, ishim familje nën shënjestër se ishim familje reaksionare si të thush. Megjithatë popullësia në vend që të na ulnin autoritetin përkundrazi na rritën autoritetin me ata. Se këta janë njerëz tamam të kombit, njerëz të atdheut, njerëz të vendit. Kshtuqë e gëzoja ni respekt, sidomos edhe në këmbë të babës. Domethanë jo vetëm ashtu po niherë në një takim që, po e quaj takim, po e përshkruaj se është rast i veçantë ç’është e vërteta. Isha djalë 16 vjeç, nëna ime bëri, si me thanë, rast që të njiheshin djalë e vajzë kështu dhe të fejojeshin. Duhet të çonim fjalën si ishte atëherë, msiti të shkonte.

I thanë nënës, nëna tha, “Unë nuk e kam burrin”, “Po e ke djalin”. Më morën mu m’çojnë me qez atje. Kur shkoj unë ishin pesë veta që pritshin fjalën time. Këta të pestë veta ishin të gjithë në moshë që unë jam sot, 80 e kusur e 90 vjeç. Më ulën në krye të vendit edhe këta pleqt ngriheshin t’më bënin mu muhabet dhe bisedë, t’më bënin shërbim unë djalë i ri 16 vjeç. Kisha ni xhirim si ky, ishte vërtetë fantasike. N’midis. “A mund ta pijmë një gotë raki?” “Po, po”, tha, “se pijmë”. Merre me mend tash unë 16 vjeç këta ngriheshin n’kambë për mu. E kam fjalën, kjo ishte edhe në kambë të babës. Baba i njohur domethanë këtë respekt.

Ose kur duhej të merrja pjesë unë në kambë të babës nëpër dasma nëpër këto. Unë isha i ri. Niherë 12 vjeç isha ulë atje me gjithë burrat e moshuar nga 70, 80 vjeç. Ata shoktë e mi luanin atje n’oborr mu m’hidhej t’dilja por duhej t’rrija aty. Mirëpo kjo ka qenë ni shkollë. Duhet t’ndëgjuar këta se si bisedonin. Erdhi i ati i Ali Musës. Ali Musa është një poet, ka vdekur. Pyti, “I kujt ish ky djalë?” I kallxuan. “Ou”, tha, mu dorën mbi kry tha, “Mos u plaksh”. Unë e mora pak si keq ata, “Mos u plaksh”. Thashë edhe unë me u bo si këta pleq, jo. Pastaj e mendova se çka domethanë ajo, “Mos u plaksh”.

Pra, edhe... vështirësia pastaj filloi plus kur nënën e pushuan nga puna si të papërshtatshme për arsim, me ndjenja nacionaliste e tjera e tjera. Kshtuqë u kriju vështirësi edhe për ne edhe nga ana ekonomike. Unë marova Shkollën Normale. Djale 16 vjeç...

Anita Susuri: Në Gjakovë e keni kry?

Agim Gjakova: A?

Anita Susuri: A në Gjakovë e keni vazhdu shkollën?

Agim Gjakova: Në Gjakovë, në Gjakovë. 17 vjeç në shkollën katër vjeçare, viti i parë katër vjeçar që u bo. Se përpara ishin dy vjeçar. Mbaronin dy vjet dhe dilnin msus. Kjo është viti i parë katër vjeçar. Më emërun dikund si fmi reaksionar, nuk e di se ku ni katun të Llapit, nuk e kisha ndërmend t’shkoja se duhej me qenë pak ma afër familjes me ndihmu me atë rrogë. Duke kaluar edhe në drejtorin arsimor

për ta ndryshuar emërimin, kishe nevojë në Gjakovë plot për katune, jo edhe për qytet po po bije fjala n'atë kohë ku kishe mësues. As që m'dëgjuan fare, a më kupton? Me fjalë tjera vraj vetën.

Duke kaluar për Gjakovë nga Prishtina në atë kohë s'ka pasur rrugë drejtpërdrejt siç është sot, duhej t'kalonim nëpër Prizren nga Prizreni pastaj në Gjakovë. Autobusi u ndal në Lipjan. Takoj ni polic, vllaun e ni shokut tonë t'shkollës, i ri ai. M'thotë mu tha, "Ktu në Lipjan nuk ka asnjë shqiptar". Viti 1952. "Si more s'ka asni shqiptarë?" "Apsolutisht nuk ka asnjë shqiptarë". Ishin edhe dy mësues të tjerë shokë të mi që ishin emëru aty. Quhej Rrethi i Sitnicës n'atë kohë. M'thonë, "Rri", tha, "ktu".

Anita Susuri: Asni shqiptarë mësues po mendon?

Agim Gjakova: A?

Anita Susuri: Asni shqiptarë mësues?

Agim Gjakova: Jo, jo, asni shqiptarë banor. Në Lipjan apsolutisht asni shqiptarë. Katunet rreth e përqark ishin shqiptarë. Në Lipjan si qendër s'kishe. Nuk ishte naj qendër e madhe n'atë kohë. E thashë do rrij. Aty shkolla tetë vjeçare fillonte nga klasa e pestë se s'kishte fillore, s'kishte banor, s'kishte njerëz, s'kishte fmi. U ndala aty ni vit pastaj ni vit në Mitrovicë edhe shkova student në Beograd.

Anita Susuri: Po m'intereson para se me vazhdu te Beogradi pak edhe për infrastrukturën e qytetit. Vendi si ka qenë n'atë kohën edhe të fëmijërisë por edhe të rinisë?

Agim Gjakova: Unë e njihja qytetin tim çdo rrugicë. S'po them çdo rrugë po çdo rrugicë. Madje duke filluar atje që quhej Çarshia, pazari pra. Fillonte nga ku është sot Rektorati i Universitetit në Gjakovë, kryt e pazarit quhej. Deri poshtë atje në mahallë, rruga ishte me kalldrëm. E kalldrëmi bjen pak si hark. Në mes ka disa gur ma t'mdhej në varg. Harku vjen që t'rrjedhë uji pak. Të gjithë dyqangjitë, e kishin me ndërgjegje se si urdhëronte kërkush, që ta pastronin terenin para dyqanit deri n'gjysmë, deri te gurtë e mdhej. Ai tjetri deri n'gjysmë dhe pazari ishte shumë i pastër. Unë e dija dhe natën duke vrapuar si fmi që loznim ne se ku mungon ai guri i madh diku diku. Pra e kom fjalën, i dija të gjitha.

Gjakova, siç thuhej në atë kohë, ka pasur dymbëdhjetë mahalla, dymbëdhjetë lagje. Ne banonim në lagjën afër Çabratit, kodrës së Gjakovës. Ato vreshnat e asaj unë i dija me pëllëmbë. Bile ai rojtari bërtiste nganjëherë se ne hinim kur fillon. E dija ku, ku fillonin kokrrat e para të rrushit të piqeshin në ato vneshta, që n'qershor. Bërtiste, "Çka doni?" Po ne nuk bënim dëme, kemi qenë edukatë tjetër. Nuk është edukata e sotshme e fmive që morën. Me ndërgjegje ruanim gjithçka çka ishte pronësi, çka ishte për t'u ruajtur.

Anita Susuri: Si ka qenë për shembull...

Agim Gjakova: Ereniku ka qenë edhe Krena. Në fillim jemi la në Krenë, aty në lum të Gjakovës pastaj jemi la në Erenik. E më vonë si të ri kemi shku edhe në Dri t'laheshim në Dri.

Anita Susuri: Çfarë njerëz kanë jetu në Gjakovë? Si ka qenë popullësia e Gjakovës në atë kohë? Njerëzit me çka janë marrë?

Agim Gjakova: Thuhet që Gjakova ka pasë diku 17 mijë banorë n'atë kohë. Ekonomia ka qenë e varur në bujqësi dhe zanate, profesione. Nuk ka pasë industri. Ka qenë ni fabrikë e tegullave, e tullave që thojshin. Ni fabrikë, ma shumë punishte se fabrikë kshtu. S'ka pasë naj industri tjetër, naj... po bujqësia kryesisht, zanatet edhe tregtia të kuptohemi. Mrena ktyre... e vërteta është që si ushqehet popullësia. Në mëngjes hahej diçka ma mirë, në drekë hahej shumë dobët, se nuk kishin njerëzit se duhej me punu.

Përveç ktyre që punonin n'fushë, ata që punon në fushë argatët domethanë e njerëzit, ata e kishin drekën e mirë, drekën e plotë se dashtë e pa dashtë... këta dyqangjitë e këta ushqeheshin me ni gotë dhallë, me ni copë bukë ku di unë për drekë. A në darkë, darkat kanë qenë me bollëk. Sidomos në vitet '41 e '44, pa ardhë domethanë, '41-'44, pa u ardhë partizanët, domethanë pa ardhë ushtria jugosllave darkat kanë qenë me bollëk shumë t'madh, se kishe bollëk ç'është e vërteta. Gjithçka.

Prodhimet ishin të bollshme, pazari i mbushur me të gjitha llojet e frutave dhe zarzavateve. Nuk mungonte as grosha, nuk mungonte asni send atë kohë. Italianët nuk bënë... në atë kohë Italia ishte, se ish edhe luftë, ishte me racione po ktu për ta mbajtë, për ta thithë popullësinë gjoja për vete e lanë të lirë. Sidomos në Kosovë e lanë të lirë këtë. Nuk përziheshin shumë. Pra, kjo ka qenë popullësia. Ushqeheshin njerëzit ma mirë. Varej pastaj sipas familjeve, si ta kuptoj njëra apo tjetra familje.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: E lagjën që keni jetu ju, si ka qenë fqinjësia? Kush ka qenë afër juve? Kanë jetu shqiptarë apo ka pasë edhe popuj tjerë, po mendoj, popullësi tjerë?

Agim Gjakova: Në Gjakovë, në Gjakovë ka qenë vetëm ni rrugë, disa familje serbe që nuk ishin shpërngulë se ni pjesë kanë ikur. Apsolutisht të gjithë tjerët kanë qenë shqiptarë. Kuptohet edhe ishin këta jerxhit, magjupët qysh dush, qysh po i qujnë sot se di edhe unë cilët janë ashkalitë e cilët janë ata. Ne i kemi thanë magjup t'gjithëve me ni ashtu atëherë edhe ata. Por e vërteta është që popullësia i ka trajtu mirë këta njerëz. Nuk kanë bo ndonjë shtypje, ndonji ndrydhje, ndonji diferencim të madh. Kshtu. Ka qenë, përta i përket feve, ka qenë musliman dhe katolik. Nuk ka pasë tjetër.

Marrëdhënjet ndërmjet muslimanëve dhe katolikëve kanë qenë të shkëlqyera, me përjashtim të martesave që aty pak ngurrohej. Të tjerat në mënyrë absolute. Ritet fetare janë mbajtur si të

muslimanëve si të katolikëve të gjitha ato të përbashkëta. Bajram, ramazan është mbajtur edhe nga katolikët. Krishtlindje e pashkë janë mbajtur edhe nga muslimanët. Ka qenë ni marrëdhënie e jashtëzakonshme. Unë du të marrë vetëm ni shembull. Unë kom pasë ni shoqe klase, ni Vera, pastaj e la shkollën a nuk di. I vllai i saj ishte ma i madh po ai nuk maroj shkollë, maroj diçka shkollë edhe ishte zejtar argjentar.

Kur ne donim t'festonim gjatë shkollës t'mesme, festonim 28 nëntorin, për t'mos rënë në sy shkonim në shtëpinë e Gjergjit. Me 27 disa herë kemi festu 28 nëntorin me datë 27. Kurrë nuk ka dalë fjalë që me dalë që kqyre këta se po t'dilnin fjalë do na merrnin me arrestim ose ku ta di unë. Pra, edhe besimi ka qenë total midis të dy palëve. Nuk, nuk, ne nuk, nuk, nuk mund të ishte në shoqëri tonë që t'bënim dallim ose të ndjehej ajo që ky është katolik e ky është musliman. Jo, jo. Ishim njisoj shokë edhe asgjë më tepër.

Anita Susuri: A ka pasë hebrenj për shembull?

Agim Gjakova: Urdhno?

Anita Susuri: Hebrenj a ka pasë në Gjakovë?

Agim Gjakova: Jo, jo. Doni ni anekdotë për gjakovarët për hebrenjtë?

Anita Susuri: Po, po pse jo.

Agim Gjakova: Thonë që erdhi ni hebrenj, ni çifut në Gjakovë për me bo tregti e tjera. Doli n'pazar me pa. Kur pa ndoni vend po i shitshin vezët me peshë, sipas peshës. "Ou", tha, "s'shitën kërkund vezët me peshë". N tjetër e kishte bë ni kallëp në qoftëse e bjen veza poshtë e hyn nëpër kallëp, nuk bën e është ma lirë e tjera e tjera. Tha, "Ktu s'qenka vend për mu", edhe u kthy (qeshë).

Anita Susuri: (qeshë) E kom dëgju këtë. Deshta me ju pytë pak për shpinë e ju. Thatë që ka qenë aty n'mahallë po si kanë qenë shpiti të tjerë?

Agim Gjakova: Dëgjo, kanë qenë, siç e tha daja i ni shokut tim kur po dal në Shqipëri niherë. Tha, "Kur shkova në Gjakovë", tha, "shpi t'vogla me tjegulla rrumbullak kшту jo tjegulla të reja. E pata ni përshtypje shumë t'keqe. Po kur hyra brenda pastaj ishte krejt tjetër". Pra, shtëpitë kanë qenë ni pjesë edhe me qerpiq, ni pjesë me tulla të kuptohemi. Ka pasë edhe me gur po rrallë, jo me gur pak. Aty ktu ndonji jo. Me gur të mdhej jo gur t'vegjël. Ne nuk kishim shpi tonë sepse kur është largu baba që thashë në vitin 1919 që ka shku në Shqipëri, ky xhaxhai edhe ai pat' ardhë në Shqipëri dhe i kishte shtëpinë për nevoja tjera se s'kishte pasë punën dhe kшту.

Në fillim burri i tezës na lshoj nga dy dhoma në kat dhe nejtëm derisa rregullum shpinë. Kemi nejtë në shtëpinë e gjyshit të nënës domethënë jo në shpi të babës. Aty kemi pasur katër dhoma. Domethanë shpi e bollshme ka qenë. Me oborr dhe me bahçe mrapa. Me podrum dy kate se vinte pak pjerrtësinë dhe kishin bo dy kate. Dy dhoma kate aty, kishin do dy kate podrum. Aty jom rritur unë. Rrugët kanë qenë me kalldrëme deri diku, po thuj, po thuj edhe rrugët e qytetit komunikonin nëpër rrugë. Edhe rrugicat. Ndonjë rrugicë e vogël mund t'mos ketë qenë me kalldrë, të tjerat kanë qenë me kalldrë.

Shpitë kanë qenë kryesisht në katëshe, aty ktu ndonjë dy katëshe. Kanë qenë disa shtëpi me karakteristike që sot e kësaj dite i marrin edhe për arkitekturë edhe për ndërtimin e tyre. Por ne kemi qenë me një shtëpi normale pa ndonjë veçansi.

Anita Susuri: Gjatë shkollimit t'juj, shkollën fillore fillimisht, domethanë ka qenë lufta e dytë kur ka fillu. Po si ka ndryshu pastaj sipas sistemit pas luftës? Çka ka qenë ndryshe?

Agim Gjakova: Ndryshimi pastaj që me programet erdhën programet serbe të kuptohemi. Na e vun rusishtën, na e vun serbishtën. Edhe në shkollë t'mesme kanë qenë. Rusishtja u hoq po mbeti serbishtja. Nga versionet që kishim në nga serbishtja, në gjakovarët nuk e kemi mësu serbishten tek deri kur kemi shku në studime që kemi qenë t'detyruar ta mësonim. Shumë pak. Ka qenë në mësues serbe që na jepte ata. Ata bënë shpesh herë me vaj të dilte nga klasa, ta linte mësimin se nuk e ndëgjoni, nuk ashtu.

Ka qenë në naivitet. Sepse në gjuhë e hujë pse ta mësosh nuk ka problem dhe më vonë e mësuam, për detyrë nga zori a qysh dush thuaje kur ishim student. Po në atë kohë jo. Fillimisht ishte gjendje pak më ndryshe, hala ishte ajo kundërshtimi shumë i madh i popullsisë, kundërshtim në vetvete kështu. Mësuesit pastaj kanë qenë kryesisht të mirë. Kanë qenë mësues që... mësues e kemi pasë në shkollë t'mesme, atëherë isha në shkollë t'mesme, s'kisha universitar. Tek vonë, tek në vitet '51-'52 e tjera ata që mbaruan në fillim shkollën shkuan në shkollë të larta pedagogjike nga dy vjet edhe u kthyen me shkollë të larta pedagogjike edhe ata me universitet, domethanë që filluan të jepnin mësim ata.

Përndryshe krejt i kemi pasë maturant. Ata kishin mbaru në pjesë të Shkollës Normale të Elbasanit. Kryesisht kishin mbaru. Aty ktu ndonjë mund të kishte mbaruar Gjimnazin e Shkodrës, ku di unë kështu. Po krejt mësuesit kanë qenë me shkollë t'mesme. Edhe kur u ndryshun programet prap ajo, si të thush, integriteti kombëtar i mësimëve e tjera dhe i edukatës u ruajtë nga mësuesit. Nuk arriti asgjë të depëronte në program asimilimi ose ku ta di, jo absolutisht.

Anita Susuri: A ka qenë e vështirë për juve normalen me përfundu?

Agim Gjakova: Jo s'ka qenë e vështirë. Jo për lavdatë po kom qenë nxanës i mirë. Kom qenë AS në matematikë. Drejtori edhe mësuesi i matematikës kur bënë detyrë me shkrim t'gjithëve përjashta, s'më linte me bo detyrën. Se e dinte që unë e bëj detyrën po i jap kopje shokëve (qeshë). Dhe njëherë

harroi t'më thoshte, "Agim dil përjashta". E dha problemin e parë, unë e zgjidha shpejt e shpejt problemin e parë. Pastaj u kujtu dhe tha, "Agim, dil përjashta". Mirëpo shkoj treshi. Me atë kopjimin e ruajta si student.

Kisha vendosur ta studioja matematikën mirëpo në vitin 1951 para maturës, pra vitin e tretë t'shköllës ashtu, ni ditë m'u dha diqysh për letërsinë. A din si m'u dha? Bëra ni hartim. Hartimi ishte ksi soji, "O' rini pranverë e jetës, o' pranverë rini e jetës e vitit". Tash ishte ni temë sa lirike aq edhe filozofike domethanë sociologjike. Unë vij, edhe mu m'kishte vu katër plus, pesshe domethanë. Të gjithë tjerët ishin me dysha, ni tresh e tjera. Se s'kishin, që thonë këta t'jugut, s'kishin qullosur naj gjo. Diqysh ajo m'u dha.

Edhe ni tjetër pastaj bëra... unë kom pasë disa revista, literatura jonë. Kishin mbetur. Se baba, jo baba nga kishin ardhë nana nuk e di. Literatura jonë. Duke lexuar kisha përdorë edhe fjalë që nuk përdoshin rëndom në mjedisinë tonë n'atë kohë. Po m'thotë profesori, "A mos ke kopju?" "Jo", thashë, "s'kom kopju po", thashë, "unë kom lexu", kto, kto. Diqysh m'u dha. E treta ishte, në vitin 1951 u shpall në Kosovë kombësia turke. Që domethanë në Kosovë ka edhe turq. Ne kundërshtuam me të madhe. Unë i njihsha mirë prizerianët që nuk e flitshin mirë turqishten se i kom pasë dajat në Prizren dhe verën atje e kaloja por ishin shqiptarë. Nuk mund të thuhej se ishin turq. Me zakone e me krejt me rraj e me skaj e me të gjitha.

Ajo me ngacmoi si të thush që... filluan edhe organizime, filloj ndjenja e organizimit për rezistencë që n'shköllë t'mesme që 16-17 vjeçar. Unë isha ndër ma të rinjtë atëherë se kisha edhe shokë të ishin 19 vjeçar 20 vjeçar. Bile edhe 22 vjeçar kishte. Unë isha ndër ma të rinjtë. Filloj ajo ndjenja e organizimit. Kjo ndjenjë e organizimit si të thush më vuri që duhet t'ja thush fjalën popullit. E t'ja thush fjalën popullit shkon nëpërmjet shkrimit e nëpërmjet shkrimit jo në gazetë po shkon nëpërmjet shkrimit, hartimit e tjera. Ndoshta edhe kjo ka qenë ni impuls që m'u dha me studiu letërsinë. Me studiu gjuhë dhe letërsi kuptohet domethanë.

Sepse natyrisht nifar' lloj naiviteti në kuptimin e ngushtë të fjalës që letërsia është ajo që i brumos njerëzit për të kriju rezistencën dhe për të luftu armikun. Ajo edhe ndihmon po s'është faktori. Po nejse, në atë kohë ashtu ishte ajo.

Anita Susuri: Po m'intereson edhe para se të vazhdojmë te fakulteti për jetën kulturore që ka qenë në Gjakovë gjatë kohës kur keni qenë në shkollë t'mesme.

Agim Gjakova: Kishte ni kinema në Gjakovë. Najherë jipej naj shfaqje ashtu. Organizonim naj festë kori e tjera e tjera domethanë kshtu. Ndonji valle ku po di unë e tjera. Po nuk kishte ndonjë jetë kulturore. Jeta kulturore e jonë ka qenë gjatë dimrit çdo të shtunë mblidheshim n'rrathë shokët dhjetë, dymbëdhjetë varej sa krijohej grupi. Mblidheshim në rrathë te njani tjetri dhe kalonim natën me biseda, me ndonjë kangë, me lonja, me biseda të ndryshme. Domethanë ajo ka qenë jeta kulturore.

Vitin 1943 se si erdhi puna në gjithë mahallën tonë, gjithë lagjën tonë kishte vetëm katër radio. Merre me mend ku ka qenë situata, gjendja. Çka do t'bësh me katër radio? Ne kishim ni radio, të kuptohet. E kishte një te Rizvanollët ata kishin ni radio, Beqiri një tjetër dhe një tjetër nuk di se ku ishte. Katër radio ishin në gjithë lagjën që mund të ndëgjoheshe. Ata na i morën pastaj ato radiot. Dikujt ia morën dikujt... pastaj mas gjashtë shtatë muajve na i kthyn prap. Me atë radio kalonim disi për t'pa çka ndodhë n'botë. Pastaj filloj me ardhë shtypi, Rilindja. T'kuptohet edhe shtypi serb Vorba dhe Politika dy gazeta qëndrore që kanë qenë. Nuk ka pasë jetë kulturore domethanë.

M'kujtohet niherë shfaqje shkun me dhanë shfaqje këta gjakovarët në Prizren. Ishte lufta partizan me gjerman dhe kishin marrë, kishin ndëgju fishekët e manovrës nuk të vrasin. Mirëpo ata nga afër janë drunj dhe të ngulet pak, të ngulet pak. I kishin marrë fishekët dhe *bom, bom, bom* {onomotope}. Njënit iu kishin ngulë dy. Po bërtiste, "O", tha, "jam plagosë me t'vërtetë". Duartrokitnin mileti se po kujtonin që vërtetë... ai those t'vërtetën, "O' jom plagosë", (qeshë). Këto kanë qenë, s'ka pasë ndonjë tjetër.

Sporti ka qenë i zhvilluar. Jemi marrë edhe si fmi që kemi luftë na fmitë, domethanë, kur ishim. Pastaj në shkollë të mesme, ekipi ynë i shkollës formonte ekipin e volejbollit për qytetin. Futboll jo se në futboll kishte të tjerë. Edhe të basketbollit. Se s'kishte tjetër. Si të thush, ekipi Vllaznimit që i shkruan, patën bo ni grup tjetër. Ne shkollarët e mesëm. Madje kur shkum niherë masi morëm maturën na çun në ni aksion, aty ishin njëmbëdhjetë brigada, ne ishim një brigadë nga Kosova prej shkollës së mesme të Gjakovës. Hajde me luftë, ne volejbol lujsim.

Na kërkun këta se na lujsim, ata student. Mirëpo në ekipin e atyre studentëve, domethanë, njëmbëdhjetë brigada ata që ishin serbe, ishin edhe dy volejbollista që merrnin pjesë në ekipin e parë të Jugosllavisë. "Hajde lujmë, hajde lujmë". Na dikur, "A këta i mujmë kollaj". A din ti që ne e fitum lojën. U tërbun. A din kujt i thonë u tërbun? Gjakova s'kishin ni kurrë për Gjakovë naj herë. Kërkun prap ndeshjen, prap i mundëm. Ikën me kry poshtë si thuhet. Pra, kemi qenë sportist.

Anita Susuri: E kur keni vendosë me shku në Beograd, a keni shku me vet financim apo?

Agim Gjakova: Niherë du t'them që deri në vitin 1954 për t'shkuar në studime duhej ta jepte lejen komiteti ekzekutiv. Nuk mund të shkoshe ti. Duhej ata me ta dhanë edhe me të çu në studime. Po t'mos dilte leja si të thush, për të mos i hapej rruga rinisë se doli Mosha Pijade¹ n'atë kohë anëtare e byrosë dhe foli. Ka qenë mars m'duket a se di. Foli, foli në radio. Bile kishte televizion n'atë kohë jo radio. Që e kemi ndrydhur rininë, do t'i japim të drejta të lira e tjera e tjera. Kush ka maru shkollën e mesme mund të regjistrohet në universitet.

¹ Mosha Pijade (Mosha Pijade; 1890 -1957), ishte një piktor serb dhe jugosllav, gazetar, politikan i Partisë Komuniste, pjesëmarrës i Luftës së Dytë Botërore dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Josip Broz Titos. Ai ishte anëtar i rregullt i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve.

Atëherë shkum, e di shkum mjaft student nga Kosova. Ne shkum rreth një 20 gjakovar. N'atë kohë në Universitetin e Beogradit ka pasë dikund 50-60 student, jo ma shumë. Ni të dhanë do t'ju japë, në vitin 1958, pra unë shkova në vitin 1954, në vitin 1958 e gjithë Kosova ka pasë 512 student. Është statistikë zyrtare e drejtorisë së arsimit, se drejtorat quhej n'atë kohë. Nga këta 512 student shqiptarë kanë qenë 128, hiç ma shumë. Merre me mend viti 1958, shqiptarë në të gjitha Universitetet e Jugosllavisë kanë qenë 128. Duke fillu prej vitit të parë deri në vitin e katërt apo të pestë.

Diku rreth një 60 në Beograd dhe dhjetë, dymbëdhjetë në Sarajevë, dy-tre ku di unë në Zagreb, një 20 në Shkup. Në shkollë të larta pedagogjike në Nish e Novi Sad kanë qenë kah dy-tre nuk e di, këta kanë qenë. Këta kanë qenë studentët n'atë kohë. Masanej u hap, filluan degët e universitetit në Prishtinë fillimisht në vitin ose janë '57 ose '58 nuk e di mirë. S'më kujtohet. Masanej u kriju universiteti. Pra, llogarit matura e parë në Kosovë ka qenë në vitin 19 mos qofsha gabim '49 në Prishtinë. Maturë katër vjeçare e shkollës së mesme. Matura e dytë kemi qenë ne në Gjakovë në vitin 1952. Pastaj vishin në vitin 1953 në Pejë, në Mitrovicë, në Prizren '53-shin, nuk e di tamam. E kështu me radhë.

Pra llogarit '52 me thonë shtatë vjet, po, '45 '52, shtatë vjet më vonë, hala s'kishte matura nëpër qytete të Kosovës. Kjo ka qenë arsimi. Kur unë kam shku msus në rrethin e Lipjanit quhej Rrethi i Sitnicës, i gjithë rrethi ka pasë njëmbëdhjetë mësues me maturë. Nga këta njëmbëdhjetë mësues tre ishim me maturë t'rregulltë, na tre shokët që kishim ardhë nga Normalja e Gjakovës. Të gjithë të tjerët ishin me kurse. Qe ishin hapur kurse në Prizren, shkojshin dy muj, ni vit edhe vitin tjetër dy muj dhe quhej se ke mbaru Shkollën Normale në thojza. Kjo ka qenë gjendja e arsimit n'atë kohë.

Anita Susuri: E pastaj juve ju dhanë të drejtën për me shku në Beograd?

Agim Gjakova: Pastaj unë isha në Mitrovicë, isha edukator konvikti dhe jipja një dymbëdhjetë orë matematikë në Gimnazin e Matematikës n'atë kohë. Kur u dha e drejta atëherë shkova, si të thashë, shkova edhe unë në Beograd. U regjistrova në Fakultetin Filozofik në degën gjuhë dhe letërsi frënge.

Anita Susuri: Si ka qenë atëherë me udhëtu deri në Beograd? Si është dokë? Beogradi si është dokë? Ajo rruga me shku deri atje? Udhëtimi?

Agim Gjakova: Po qytet i madh. Në të vërtetë nuk më ka bo naj përshtypje, flas për vete nuk e di për të tjerët. Ndoshta edhe ish ajo paragjykimi që ky është ni qytet, ky qyteti i shkijeve që themi ne. Ky qyteti i serbëve dhe nuk, nuk na nxe, nuk na ngroh. Megjithatë kemi qenë të detyrun. Se unë pak serbishten fillova ta mësoj nëpërmjet gazetës Politika. Se më interesonin. Më interesonte me ditë çka po ndodhë në botë e tjera e tjera. S'kishim ne shtyp. Rilindja, s'ishte ndaj... s'kish edhe korrespondenta. Ata kishin korrespondentë, Politika. Nëpërmjet saj, domethanë, pak a shumë mësova diçka.

Pastaj në Mitrovicë si edukator konvikti kishte, ishin një 17-18 shqiptarë një 40 e kusur ishin serb. Serb e serbe nxanës që vinin në konvikt, që vazhdonin gjimnazin. Ata gjimnazin serb këta gjimnazin

shqiptarë. Me ata në komunikim me serbët dashje padashje duhej të komunikoja serbisht. Në atë kohë duhej t'përmend në vitin 2004 u festu përvjetori i normales në Gjakovë. Neve katër vjeçarëve nuk na kishin shti në program me folë dikush aty, po i kishin marrë ata pak ma t'vjetër që ishin. Unë i them atij koordinatorit dhe asaj i thashë, "Du me folë", thashë.

Ma dha fjalën natyrisht. I thashë, "Ne jemi", thashë, "ni brez që shkuam në shkollë, mësuam dije po mësuam edhe t'i dalim zot këtij vendi. Të mundohemi t'i dalim zot këtij vendi. Ne jemi", thashë, "ata t'parët që kemi bo greva parë në Serbi, mos t'them në gjithë Jugosllavinë në shkolla. Ne nuk shkuam njëmbëdhjetë ditë në shkollë", bojkotua mësimin. Për arsye se na hongrën të drejtën që e kishin të gjithë maturantët e të gjithë shkollave të Jugosllavisë, neve si shqiptarë na hongrën të drejtën. Të drejtën nuk na dhanë mundësinë që të shkonim në ekskursion nëpër gjithë Jugosllavinë. U bo ni problem shumë i madh në drejtorat ndoshta edhe ma lart, ku ta di unë. Dashje pa dashje u detyrun që t'na jepnin edhe neve t'drejtën dhe e fitim. Por është greva e parë.

Mirëpo unë kam edhe fotografite nga ajo greva e tjera. Ajo na brumosi si të thush, na lidhi njëri me tjetrin. Ne kemi qenë gjithë t'lidhur njëri me tjetrin pavarësisht nga vinin. Kemi pasë nxanës nga Prishtina, kemi pasë nxanës nga Suhareka, kemi pasë nxanës nga rrethi nga Peja domethanë. Ishim të gjithë unanim. Domethanë s'kishte tërheqje, s'kishte dallim. Kjo edhe ajo organizimet si të thush, ajo shoqni që të thashë në mramje, ato mramjet e tjera, midis tjerave bisedonim edhe tashi si shkollar ishim ne ata që duhej, duhej... ishim ne ata që duhej ta merrnim shtafetën e një rezistence.

Se u bë që u bë rezistenca, u pushkatuan të gjithë ata që edhe njerëz me faj e pa faj. Njerëz që s'kishin përzi në politikë as kurgjo. Mbi 40, mbi 35 mijë, 40 mijë shqiptarë burra u ekzekutun në gjithë Kosovën janë 200 e kusur vetëm në Gjakovë. Pra, u kriju vetëdija që jemi na ata të cilët duhet të mbrohem, duhet të rezistojmë, duhet ta krijojmë rezistencën për këtë komb. Në radhë të parë për lirinë dhe pastaj edhe për bashkimin për Shqipërinë siç ishte atëherë parolla. Me këto andrra, me këto dëshira shkova student.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Ishim duke bisedu për studimet. Fillimisht kur keni shku a keni qenë ndonjë banesë a në konvikt?

Agim Gjakova: Në konvikt, në konvikt, në konvikt të studentëve. Të kuptohemi, ne s'kishim msu gjuhë t'hujë, s'kishim. Frëngjishten veç kot si kshtu. Të tjerët student që ishin atje kishin bërë tetë vjet kishin mësu. Me fjalë tjera kishin ni bazë. Megjithatë arrita të jap provimin vitin e parë edhe vitin e dytë. Kisha letërsi po unë zgjedha, zgjedha frëngjisht dhe zgjedha letërsinë botërore. Për letërsinë botërore kom qenë student që nuk merrja pjesë në leksione, nuk shkoja. E kisha mund t'quaja humbje kohe. Atë çka

do t'thotë ai, n'vend se ai i thotë 80 faqe unë do t'i lexoj 30 faqe për ato dy orë dhe dy orë prej Beogradit e hupshe gjithë paraditen për t'shku n'leksione n'universitet.

Në vitin e tretë të letërsisë botërore ose mesi, dhatori ishte, na thanë që profesori do t'japë firmat. Se duhej ta firmoste profesori indeksin që gjoja ke ndëgju ato semestrin që t'regjistrosh semestrin tjetër. Ashtu ishte rregull. Po ajo ishte formalisht se s'ishte kshtu, nuk i merrte kush shënimet kush po vjen e kush s'po vjen. Unë dojsha t'kthehesha t'shkoja në Gjakovë, t'vija në Gjakovë për vit të ri. Shkoj t'i them atij profesorit, të lutem që t'ma japësh nënshkrimin në indeks.

Shkoj n'katedër. Po i shoh në ni parathomë sekretarja ni gru e atij, shefja e kabinetit të profesorit, ni gru nja 55 vjeçare po bisedonte me ni burrë. Ni burrë nja 55 vjet po shikonte n'raft ato raftet e librave për t'gjetë ndonjë libër. E ky duhet t'jetë ktu ndonjë asistent se kishte asistent të profesorëve. I ofrohem, "A është profesor", filani, "ktu?" Kisha dëgju, kisha dëgju dy vjet e gjysë mësim, leksione. "A është profesori ktu?" Tha, "Po për çka do?" Thashë, "Desha t'i lutem për nënshkrim", "Ku e ke indeksin?" "Urdhno". Tha, "Nuk ma paske shkru as emrin". Ai kishte qenë profesori (qeshë).

Anita Susuri: (Qeshë) ju as që e keni njoftë.

Agim Gjakova: Kisha shku nja dy herë po kishte ardhë asistenti i tij ni Rashko Dimitriviç. Ky Boislav po s'po m'kujtohet mbiemri. Tashi edhe unë u preka ç'është e vërteta, m'erdhi rond. Tashi demek dy vjet e gjysë unë s'e njifsha profesorin. Ai filloi me qeshë, buzëqeshi. Nuk u mërzi për atë punë. "Se du me shku për vitin e ri", m'tha, "Çka je ti? *Šta si ti, Crnogorac* [Çka je ti, malazez]?" se gjuha jeme nuk ishte dialekti serb edhe i Beogradit. "Jo", thashë, "shqiptar", "Mirë", tha, "me fat viti i ri dhe shko". Shumë n'rregull. Edhe kshtu.

M'kishte mbajtë mend po s'i kishte ndodhë as atij ksi soji kurrë (qeshë). M'kishte mbajt mend fort mirë. Kur shkoj n'provim tha, "Ndëgjo", tha, "nëqoftëse ti nuk je n'gjendje me u shpreh lirshëm serbisht", tha, "unë jom n'gjendje me t'dëgju anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht. Katër gjuhë", "Jo", thashë, "unë po mësoj frëngjisht po serbishten e kom zotëru ma mirë", "Hajde fol". Ra... m'kujtohet si sot, ishte pytja e parë tiparet e romantizmit në letërsi. "Ku i ke lexu", tha, "kto?" Disa sene që s'ishin n'leksione s'kishin qenë leksione ku di unë. I thashë, "I kom lexu n'letërsinë frënge, n'librat frënge", "Shumë mirë bravo, bravo shumë mirë".

Pytja e dytë ishte Vëllezërit Karamazov, romani i Dostojevskit. Thashë, "Kom lexu Krim e Ndëshkim, nuk kom arritë ta lexoj", thashë, "se ne s'kemi pasë letërsi. Po", thashë, "në qoftëse doni po flas nga kritikant". "Ndëgjo", tha, "ti nuk më gënjeve mu dhe unë nuk t'gënjej ty, kalo n'pytjen e tretë". Me fjalë tjera kritikant sikur i ke lexuar ti. Pytjen e tretë ishte Çajld Haroldi i Bajronit, nuk di ju a dini letërsinë?

Anita Susuri: Po, po.

Agim Gjakova: Unë bana ni krahasim ni krahasim thashë, “Bajroni erdhi në Ballkan”, thashë, “si ata haxhitë që t’shkojnë n’qabe për t’pa çka ka çka s’ka”, “Bravo, bravo, bravo”. Ma dha... prit ma dha tha, “Shko”, tha, “n’katedër”, ma dha ni letër, “thuj sekretarës ose shefës me ta jap”, tha, “librin nga biblioteka jeme”. Dal e pyes, “More kush osht’ qiky”, se kemi pasë profesor shumë t’ngarkun shovinist. Ky sjellje e tillë e ni demokratit. “Dëgjo”, tha, e pyesja ni asistent atje e njihsha kshtu. Tha, “Profesori”, tha, “është shumë i zoti nuk është”, tha, “me regjimin po”, tha, “meqenëse është shumë i aftë nuk kanë çka i bojnë dhe nuk përzihet me bo ndonjë budallallëk në politikë”, tha, “edhe e bajnë. Po është me fjalë tjera demokrat nuk është komunist”.

Ka pasë të tjerë ka qenë ni Pavloviç ni femër. Ka qenë ni Fetije Bishaka nga bashkëstudent nga Peja i thonte Pavloviçka për tallje. Hajt po shkoj niherë te kjo. M’çoj, “M’i trego”, tha, “konotacionet”, kuptimet që ka ni fjalë, shumë kuptime. “M’i trego konotacionet e fjalëve refleksio”, i thashë, “Pasqyrim, reflektim, mendim, sipër hedhje”, kto që vijnë dritat e tjera. “Tjetër, tjetër”. Edhe francezin me pytë tonat nuk i din. Ajo donte ishte me kunjë, e dija unë këtë punë.

“Kaq”, thashë. “Ku e ke mësu”, tha, “gjuhën e hujë”, thashë, “N’qytetin tim, n’vendlindjen time”. “Çfarë gjuhe t’hujë”, tha, “ke mësu”, “Gjuhë të hujë”, thashë, “unë kom mësu serbishten”. Si me i pasë picku gjarpëri apo akrepi. U tërbu nga inati midis gjithë studentëve, 60-70 student. Unë i thashë, “Gjuhë të huaj kom mësu serbishten”, gjuhë e huaj serbishtja. U tërbu, u tërbu nga inati. U dridh. Dhjetë sekonda 15 sekonda hiç ma ktheu shpinën. I tha dikujt, “Vazhdo”. Unë dola përjashta s’ia kom pa ftyrën ma kurrë (qeshë). Nejse m’u m’kapi rrëmuja pastaj ika nga universiteti. Provimet...

Anita Susuri: Kur ka fillu aktiviteti?

Agim Gjakova: A?

Anita Susuri: Dëshët me thanë edhe diçka, urdhno.

Agim Gjakova: Jo provimet kanë qenë normale, si të gjithë të tjerët. Ka qenë letërsi, ka qenë latinishtja. Latinishte ma dha ni shtatshe ajo. S’kishim bo more na as latinisht as frëngjisht as kurgjo. Gjuha e huj do kohë sado i zoti që t’jesh nuk mund ta përvetësosh po s’pate kohë. Se duhet të flejnë ato, po s’fjetën në gjuhë t’hujë s’munësh me mësu. Nuk është si historia e merr ni mësim, tre mësimë i mëson edhe natën e mirë i din. A në gjuhë t’huja, gjuhë t’hujë mirë që s’e ke mësu emrin mirë e mirë po s’e ke mësu mbiemrin shumë mirë të del diçka që mbiemri që s’lidhet. Po mirë, në përgjithësi mirë.

Naj aktivitet nuk ka. Atë që ta dhashë për... jo aktivitet po. Fillum orë letrare në, si i thonte Selman Riza, seminar i gjuhës shqipe. Nuk i thonte katedra po seminar (qeshë). S’bohej naj gja ishte i dobët ai seminar po nejse hajt. Bënim orë letrare. Mbahej niherë në dy muj niherë, se di. Bënim orë letrare, lexonim kshtu, diskutonim për njëni shokun e tjera tjera. Bile ishte edhe Adem Demaçi dy vjetet e para pastaj u kthy ai. Lexohej diçka, nifar’ proze, ni tregim. U ngrit njëni e kritikoj pak. Ademi u nxe se ka

qenë zevzek kshtu prej natyre. U nxe pak tha, “Pse nuk më mbrojtët ju mu”, tha, “nga ai?” “Adem”, thashë, “çka t’boni ai? Ai tha disa mendime punë e madhe ndaq merri ndaq mos i merr”. Nejse.

Pra, bënim orë letrare kjo ishte. Kisha student që shkonin nëpër ballo që i thonë, nëpër këto igranga që i thoshin serbisht. Unë rrallë e tek kom shku kur m’kanë marrë ma shumë, me dhunë, me dhunë domethanë kshtu hajde, hajde, hajde. Isha student që s’kisha *stipendi*, s’kisha bursë. Merrsha dy mijë e 200 dinar, bursa ishte pesë mijë ose gjashtë mijë dinar. Merrsha dy mijë e 200 dinar si shtesë fëmijërore në pensionin e nanës. Pensioni i nanës ishte tre mijë dinar, hiç ma shumë. Me fjalë tjera në gjendje të vështirë. Nuk di. Me ata dy mijë e 200 dinar pagujsha 800 dinar konviktin, 1200 dinar drekën. Për darkë e për mëngjes ha ku t’dush. A din në kuptimin e ngushë me ata 200 dinar. Nejse.

Niherë me nja tre shok shkum e shkarkum ni kamion me drrasa në stacionin e trenit. Nja shtatë orë valla që s’mujshim me drejtu shpinën nja tre ditë rresht masanena. Na dha kah 800 dinar. 800 dinar sa me mbulu dhomën. Botova ni tregim në Rilindje e mora ni honorar. Nja dy tregime. Se fillova pak t’shkarravis si të thuash, të shkruj. U bo ni festival i studentëve në Shabac. Unë e kisha përkthi ni tregim, tregim me emrin Hiri. E lexoj mbas studentëve atje e lexoj. Atje kisha përveç jurisë që ndate çmime kishte edhe çmimi i publikut.

Kishte ni fletë të gjithë ata që dëgjonin do ta shkruanin titullin e asaj pjese, atij tregimi, asaj vjershe, asaj që i ka pëlqy. Të gjithë e kishin shkru, jo të gjithë po pjesa ma e madhe e kishin shkru titullit e tregimit tem. Aty m’i dhanë dy mijë dinar. Me fjalë tjera kshtu. Derisa hyni motra n’punë pastaj në vitin e tretë pak ma ndryshe, u rregullu ajo situatë. Me fjalë tjera s’di çka domethanë me hangër mjes si student. Kshtu. I kisha shoktë të cilët nuk m’lenin me vujtë ne kuptimin e ngushtë kshtu. “Hajde”. Naj bon, naj m’the e të thashë. Ose kur banonim me qera ose se kishe kshtu. Kjo ka qenë jeta ekonomike e studentit. E imja kryesisht jo e të tjerëve.

Anita Susuri: Ju m’tregut edhe e lexova që keni formu ni shoqatë Përpjekja.

Agim Gjakova: Po, si thashë, ajo brumosja jonë e sidomos mund t’kem qenë djalë që themi, djalë ma krye kçym kshtu ma i avansun a qysh t’dush thuje. S’mujsha vetvetiu familja, ajo edukata politiko-shoqërore n’familje me babë, me nanë, me tjera e tjera e kom njoftë Emin Durakun sekretar e të tjera. I njifsha se aty baba kryetar. Po ishte kriju ajo që na duhet m’i dalë zot ktij vendi, duhet diçka t’bëjmë. Më lindi ideja që ta formojmë Shoqatën e Studentëve Shqiptarë në Beograd.

Kjo nuk ishte thjeshtë ni shoqatë kulturore-letrare. Por ishte në mënyrë legale ni organizim ku na do t’zhvillonim pastaj veprimtari ilegale tonën. Por që ta kemi mburojë këtë anën legale të organizimit, jo ilegale. Që më thoni e ke mendu mirë. Në fillim bisedova me shoktë ma besnik, ma t’devotshëm që ishin këta. Dakord ishin. Më pranun që ta krijojmë. U bo mbledhja, ishte orë letrare. U ngrita dhe shpalosa konceptin dhe idenë edhe kërkesën për krijimin e shoqatës. U miratu nga të gjithë.

Që t'mos mbetej që jemi veç ni grup e bëm që të kaloj në ni fletë dhe t'gjithë të nënshkruanin që janë dakord për krijimin e shoqatës. Përveç, edhe Setki Imami ka qenë aty, punonjës i vjetër në Beograd. S'di a ka qenë Anton Çeta s'më kujtohet mirë. Dançetoviqi që ishte shef katedre ai nuk e nënshkroi. Shkum e kërkom Mehmet Hoxha ka qenë zëvendës ministër për diçka valla, ku di edhe unë për Serbinë. Që t'na jepnin nifar', nifar' financimi si shoqatë. Ne takum nënkryetarin e Republikës së Serbisë. Ai na dha 50 mijë dinar. 50 mijë dinar ishin goxha mirë.

U detyru drejtorja e konvikteve e qytetit studentit me na dhanë ni paradhommë dhe ni dhommë që ta vendoseshim ne aty. Me fjalë tjera u bë ni bujë e madhe, ni rokopujë. Po në anën tjetër e tërboj sigurimin jugosllav, UDB-në. As serb, as malazezët, as kroatët, as sllovenët as kërkush s'kishte shoqata jashtë, jashtë shtetërore. Ne shqiptarët ishim t'vetmit. Ishim ni grup, ni shoqatë mu n'gojën e ujkut si të thush, mu n'zemër të Serbisë në Beograd. Blem ni radio, e vendosëm atje. Fillun këta studentët shkuan e dëgjonin radio Postën që jipte Tirana. Kshtu.

Po i thashë, "Vetëm këtë jo lajme asi sene se pastaj na vënë në shënjestër. E muzika është muzikë", e të tjera e të tjera. Kshtuqë u bo kjo domethanë në zemër. Shkum, Syrja Popovci që ishte jurist i thashë, "Syrja", i thashë, "na krijo ni statut të shoqatës se programin e kemi na se çka qysh po ti krijo statut". E bëm ni statut të shoqatës dhe shkum te Mika Tripolo. Mika Tripolo ishte sekretar i përgjithshëm i gjithë rinisë së Jugosllavisë. Na priti. Donim që të nxirrnim ni revistë. Kjo revistë... në atë revistë do ishim, e kishim menduar që kjo revistë t'ju dërgohet edhe atyre anëtarëve që do ta krijonim ne organizatën tonë të rezistencës.

Nëpërmjet listave që i shpërndanim, për shembull, numri shtatë çdo shtatë, 17, 27, 37 do t'jetë ni anëtarë që bon pjesë në organizatë. E tjera, e tjera. Kjo është anë teknike e asaj. Mika Tripalo na priti mirë. Tha, "Mirë mirë boni ni elaborat për shpenzime e tjera". Na i tham, "E kemi gati, është nja tre milion dinar". Ai, "Nuk ka ndonjë gja tre milion dinar". Ai fjaltë e mira, siç thonë këta jugu, fjaltë e mira gurtë në troç, s'u bo kurrë ajo punë. Shkoj u përhap gjithandej u bo tollovi e madhe.

Me siguri i thanë Fadil Hoxhës me ardhë me bisedu me ne. Fadil Hoxha erdhi. Kishte marrë Kolë Shirokën dhe ni tjetër. Ky ishte n'atë kohë vazhdonte shkollën e partisë. Me thanë që ka qenë Sinan Hasani, nuk m'kujtohet. Do ta pyes bile ni shok temin a din, a mban mend kush ka qenë n'atë rast ose naj tjetër. Tre erdhën. Fadili tha, "Për revista nuk ka mundësi m'u dhanë po ne do t'i themi Zanit të Rinisë që t'ju japë faqet juve me botu". Unë s'e kisha hallin thjeshtë të botimit se edhe kshtu m'i botonin se s'ishte naj problem. Përveç kur ke sene që nuk shkojnë. Pra, mbi këtë bazë kshtuqë mbeti ajo punë. E arrestun Ademin ktu në Prishtinë...

Anita Susuri: Adem Demaçin?

Agim Gjakova: Adem Demaçin '58-ten. Erdhi hetues ka qenë ni Çanoviç ka qenë udbash në Drenicë pastaj erdhi. Kishte marrë landen e tij erdhi në Beograd. I thirri të gjithë studentët shqiptarë me radhë.

I thirri ata që ishin ma neutral. Ishin tronditë nga dy student bashkëkombësit, bashkëqytetarët e mi se i kishte thirrë UDBA. Unë shkoj i them, “Mos u tremni, ju s’keni kurgjo s’jeni përzi n’kto punë”. Ditën e martë i thirrën krejt në grup që du ta përshkruaj këtë grup që kishin marrë pjesë në nifar’ muhabeti ktu në Prishtinë. Ditën e mërkurë disa të tjerë. Ditën e enjte më kishin lënë mua dhe Aliun, Ali Aliun profesorin.

Ali Aliun e kishin thirrë për orën 10:00 mua për orën 01:00. I thashë, “Ali neve”, thashë, “kanë me na arrestu”, “Jo more, i kanë liru këta tjerë”, “Përgaditu, ne kanë me na arrestu neve të dyve”, “Mirë”, tha. Shkoj Aliu. Shkoj unë në orën 01:00. “Hajde”, tha, “fol çka ke vepru kundër Jugosllavisë?” “S’kom vepru kurgjo as s’veproj”, “Nuk bon fajde me kto ky muhabet atëherë n’burg”. Pesë ditë. Më torturun mirë e mirë e tjera e tjera. Unë kisha shku edhe në Ambasadën Shqiptare. Në Ambasadën Shqiptare ata m’pritën kështu mirë po ftoft në kuptimin e ngushtë.

Kisha përgadit përgjigjen. “Pse ke shku në ambasadë?” Ata e dishin se kanë nxjerrë shënimet atje. Vesh gojë ambasada me gjithçka. Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishin në tel, ishin në fazën ma t’keqe midis tyre. Thashë, “Kom shku t’kërktoj”, thashë, “pensionin e babës sepse ju nuk m’jepni mu”. “Ti”, tha, “je fëmijë reaksionar. Axha yt ka vra”, tha, “Milladin Popoviçin”. Thashë, “Po baba jem që ka qenë kryetar i Këshilli Nacional Çlirimtar pse s’e merrni për bazë?” Tha, “Nuk t’japim bursë ty”. Aty s’dishin çka me thanë.

Thashë, “Unë nuk jom kundër popujve të Jugosllavisë, jom kundër kësaj lloji politike të regjimit që bie ndaj njerëzve. Të gjithë duhet t’ketë të drejtat e bursës e krejt”. Nuk firmosa kurgjo. Pesë ditëshi ose duhej me m’lëshu ose duhej me më mbajtë me orë t’gjata sipas ligjit. Më lëshuan. Pastaj herën e dytë, po herën e dytë kam mbajtë. Dy ishim bashkë me Aliun. Shtatë javë. Atëherë gjithçka masanej...

Anita Susuri: E herën e dytë pse ju morën? A bonët naj aktivitet apo?

Agim Gjakova: Jo, jo ne ishim në shënjestër. Unë po dojsha me fillu gati m’u përgadit për ashtu. Mirëpo me u përgadit me dhanë provimet e fundit për me mbaru fakultetet. Arrestimi jem ka qenë shumë interesant. Siç thashë mu më erdhi malli për Gjakovë. Ne kemi pasë gjashtë udhëtime me pagesë në të katërten për trenin. Kështuqë bileta nga Beogradi deri në Pejë me tren kushtonte dy mijë e 200 dinar. Unë pagujsha 550 dinar, në të katërten. I kom shpenzu gjashtë udhëtimet e mija i kom marrë edhe të shokëve.

Ni Imer Ijakës ngjasonim pak, nga dy-tre. Ata nuk i shpenzonin, nuk e di. Mu më merrte malli për vendin tem, ashtu asi. Kur dilja në mëngjes në Luginën e Drinit dhe kur ishte pranverë dhe binin rrezet e para në atë ujë, ai reflektimi ishte i mahnitshëm ai peisazh. Kisha ardhë në Gjakovë. Me shoktë e mi, krejt kanë vdekë, po pinim nga një gotë atje në kafe ashtu. Ni djalë i tezës i jemi, që ka vdekë, aty ishte me ne. Shkoj me folë n’telefon se kishte në motorr. I pari që ka pasë motorr në Gjakovë në vitin ‘56, ku di

unë. Se ju kishte ça ni gomë dhe kishte thirrë ni shok tonin në Beograd me ia gjetë ni gomë me kqyrë në Beograd.

U vonu. Atëherë s'ka pasë telefona kshtu duhej t'shkoje në postë që të flisje edhe ai n'postë edhe ti n'postë. Kur vjen ulet afër meje dhe ma bon bëm, bëm, bëm {onomotope} "Çka ke more? Prit", ne po lujshim. Bëm, bëm, bëm {onomotope} a din, çohu, çohu. "Prit ta mbaroj lojën dhe ta pij këtë gotën". Në vesh m'tha, "Sonte", tha, "e kishin arrestu Ali Aliun. Kanë shku s'më kanë gjetë mu aty. E marum lojën. Ka qenë Qazim Lleshi, Avni Lama, Kadri Kusari, Abdurrahman Koshi edhe unë. Shokë t'ngushtë ni për të gjithë të gjithë për ni, siç kemi qenë atëherë.

E përcollëm Qazimin, ma i vjetër nuk ishte në grup tonë. Grupin tonë kshtu. I them, "Mos sonte", thashë, "mu nesër më arrestojnë". U pren këta shoktë, e dishin çka vjen mas arrestimit. Po m'thotë Kadri Kusari, "Agim", tha, "a bojmë diçka? A t'përcjellim deri n'kufi", tha. Ka qenë djalë trim. "A t'përcjellim deri n'kufi", tha, "dhe të ikësh në Shqipëri. Që ta shpëtosh jetën se s'i dihet". "Jo", i thashë, "çkado që të ndodhë", thashë, "ju duhet të jeni të vetëdijshëm që ne nuk mujnë me na thy. Pra, mu nuk mujnë me më thy. Unë e kom vendosë". Po m'thotë ky djali i tezës, "Du me ardhë me ty sonte me fjetë", "Çka po don me ardhë me të gjetë edhe ty pse? Për çka? Shko n'shpi tane ik". Shkoj. Nanën nuk e kisha ka qenë ni teze atje. I thom tezës, "Ik flej teze".

Pjesa e Katërt

Agim Gjakova: Ngrihem nesër s'po luan kurgjo. Dal atje dhe e thras djalin e hallës. Halla me burrë të pushkatun. Pra, familja jonë të zhdukun totalisht mashkujt. Që as vorrin sot e kësaj dite nuk ia dijmë. Me pesë fëmi pa kurfar' profesioni me vek, a din me vek që thojmë na, i ka rritë me thojt e durve këta fëmitë. Djalin ma t'madh 14 vjeç ia kishte lanë. Tash ish rritë ky. Po luanin, ishin mbledhë me shok. E thërras i thashë kshtu, kshtu i tregoj thashë, "Mu më arrestojnë". I mbeti fytyra kaq {shpjegon me duar gjysmë pëllëmbë}. S'nxirrte dot fjalë, s'nxirrte dot fjalë. Ishte... e preka.

Çka do t'i thotë nanës t'vet që jom i vetmi nip nga aktër vllazën? Marrëdhانيت tona kanë qenë të ndryshme familjare kanë qenë shumë ma të afërta, ndoshta sot mund t'mos jenë. Tha, "Do vi me ty", tha. "Jo, s'ki nevojë me ardhë". A din, nëqoftëse shkon n'shpi. Po e shoh ni invalid ka qenë ka pasë ni makinë të invalidëve. Vërr {onomotope} po vjen. Kah shkojsha unë vinte edhe ai. Ai ishte ni agjent, e diujshim. "Eh", thashë, "t'paska ardhë urdhëri". Domethanë qenka marrë vesh kjo punë.

Shkoj n'shpi unë, tezja... nana ishte në Prishtinë te motra siç thashë që kishte fillu [punën]. Dhe kishte bo burjan themi na, mish me oriz dhe spinaq. I hongra njo dy lugë, të them të drejtën nuk m'hahej në atë presion psiqik. Kur hyjnë në oborr shefi i UDB-së tha, "Agim", tha, "kemi ardhë për ty". Desha me i thanë e di po nuk i thashë (qeshë). Rastësi. Mirëpo nuk i la me m'lidh kshtu. "Ku i ki ato librat ato

shkrimet?” Ai ni Stanoja zëvendës shef ka qenë ni kriminel i klasit t’parë që e ka torturu ni shokun tem në burg, Avni Lamën, mos pyt.

E pa në libër “*Šta je ovo* kuq e zi këtu?” Ky i tha, “Le a nuk e sheh që është libër i leximit?” Libër i leximit i klasës së tretë vjersha e Asdrenit për Kosovën kuq e zi. Nejse. Nuk i la me m’lidhë, e tregoj edhe psenë. Kurgjo. Me fjalë tjera tha, “Të kërkon Beogradi, unë s’kom dorë”, ai u shpërta ai si vetja, si shef i UDB-së. Pastaj filloj. E pse e mbajti ky këtë qëndrim? Në vitin 1956 e mbyllën gjimnazin. Gjakova, djepi i arsimit në normale me tjera e mbyllën shkollën e mesme me qëllim t’caktun. Ni popullsie me 20 mijë banor s’kish mrri n’atë kohë.

Në ni orë letrare në Gjakovë unë lexoj poezinë mirë i Sharraxhiut me motivin, “Unë jom bir i sharraxhiut dhe ashtu dua t’jem, por biri im sharraxhi s’do t’jetë”. E lexoj në mramje të nesërmen n’mjes në orën 07:00 bam, bam {onomotope} dera polici, milici, “Hajde po të thurret Laza”, shefi i UDB-së. Kumeditë çka i kanë thanë Lazës ata komiteti i partisë e këta. Kur shkoj atje filloj me bërtitë, “Çka ke shkru ashtu?” Bërtit e bërtit. Unë po e kqyri i qetë kshtu siç po të kqyri ty. T’u u ulë, t’u u ulë tonin, u ulë, u ulë. Pushoj. U pushoj. Po m’kqyrë ai mu edhe unë po e kqyri.

Po m’kqyrë me sy kshtu. I thashë, “Nuk e di çka ju kanë thanë juve po kjo është ni poemë për ni popullësi për disa, ni strukturë e cila nesër me zhvillimin e Jugosllavisë do t’gjejë vendin në industri e tjera e tjera. Bile osht’ përkthi”, thashë, “edhe serbisht. Mund t’botohet me ni revistë në Beograd ja në Delo”. “Agim”, tha, “unë nuk marrë vesh nga ato të letërsisë. Po”, tha, “unë nuk du t’kem shqetësime ktu në Gjakovë. A u morëm vesh?” “Po u morëm vesh”, “Hajt ditën e mirë”, “Ditën e mirë”.

Mirëpo i kish thanë ni udbashi shqiptarë, “Çka osht’ more ai djalë? Unë s’i lash gjo pa i thanë ai veç m’kqyrte rrinte heshtur kurgjo. Unë kom kriju ni respekt”. Prandaj ai nuk i la me m’lidh. Masanej në Beograd fillun ato torturat. Veç ni torturë, nuk është torturë po është mundim. Masi m’i kishin thy dhomt e tjera, s’po hi me i përshkru ato. Ishte nënkolonel i UDB-së dhe ni kapiten, te dy që më merrnin në pyetje. Tha, “Ty”, tha, “nuk të bon fajde dajaku fizik. Ty duhet me ta shkatërru sistemin nervor dhe atëherë”, tha, “ti dorëzohesh”. S’nepsha përgjigje unë, ti fol sa t’dush unë s’jepsha përgjigje. “Fol çka ke ba?” S’jepsha përgjigje. Kshtu, kshtu dhe unë hiç heshtje varri.

“Firmos këtu”, “Jo, me firmos nuk firmos”, “A nuk firmos po ta rregullojmë qefin”. Më çuan në qeli, nën tokë. Vjen ai gardiani, “Hajde, po ti e kishe edhe ma poshtë”. Më shtyn me ni koridor dhe më futën në ni qeli sa prej zonjushës deri këtu [afërsisht dy metra]. Kaq. Dera e mbyllne hermetikisht me llastik mos me hy ajri, mos me dalë ajri. Taman si n’varr. Mur betoni, mur, mur, mur, derë e hekuri. Pa dritë, pa dritare pa kurgjo. Isha i trullosur nga tortura tashi sa kohë ka zgjatë nuk e di. Po filloj me ra një si vesë, a din lagështi që vjen, jo shi po si vesë lagështi. Unë fillova t’mos e ndjej trupin tim. Sikur nuk jom ky, sikur jom ma i gjatë, sikur ma i shkurtë, sikur kjo kamë ma e madhe sikur kjo kshtu. Me fjalë tjera përceptimi i hapësirës filloj me u turbullu. Vetëdija filloj me u turbullu. Kishin fut gaz apo naj drogë nuk e di se çka. M’ka ra t’fikt.

Kur vi në vete jom i shtrim në kokërr shpine në dhomë të hetuesisë. Po du me u çu po m'dhem krytë ktu mrapa {prek kokën mrapa}. M'kanë tërhjekë prej kamsh, krytë a nëpër shkallë a në prag dere kumeditë ku ka zanë. Kungull hesapi, punë e madhe. Po. Më hypi sipër ky, unë i shtim në kurriz. Me ironi tha, "He", tha, "si po e ndjen vetën?" Edhe siç m'thonin kta shoktë e mi, "Ti nuk je budall po je supër budall". Unë i thashë, "S'ka ma mirë" (qeshë). U tërbu. E di kujt i thonë u tërbu? U tërbu fare. U dridh nga nervozizmi. Për mos me kallxu atë nervozizëm, a po merr vesh, iku dul përjashta e la kapiteni ishte aty.

Ky ka qenë ajo ni torturë. Ato tjerat dihet. Kur ashtu u dërmishe me hund me gjak e tjera. E thirrën mjekun se m'ra t'fikt nga torturat fizike. E thirrën mjeku. Mjeku tha, "Nuk ka kurgjo", tha, "po e ka nga kjo". Demek e ka nga halli i madh që s'don me kallxu. Unë s'kom firmosë kurgjo, apsolutisht.

Anita Susuri: Sa kanë zgjatë hetimet?

Agim Gjakova: A?

Anita Susuri: Hetimet sa kanë zgjatë?

Agim Gjakova: Nja gjashtë-shtatë javë. Me 29 prill, dy herë jom arrestu me 29 prill. Më kanë lshu në fund të majit, katër javë, pesë javë. Në fund të majit në fillim të qershorit se di, s'kisha as data. S'po m'kujtohet tash mirë tamon. E kom shënu dikund. Gjatë kohës që isha në burg vjen ni hetues i Beogradit, ni prokuror se thashë hetues. E hapë derën e çelisë pa hi brenda aty në çeli tha, m'i lexoj tri akuza themelore.

Tha, "Çka ke me thanë?" "Sipas akuzës së parë që e lexut aty dhe që e shikon dënimin me pushkatim", thashë, "ju mu do t'më pushkatoni. Sipas akuzës së dytë", thashë, "që edhe kjo dënimi është me pushkatim do t'më ngjallni", thashë, "nga pushkatimi i parë do t'më pushkatoni për herë të dytë. Sipas akuzës së tretë që parashikon 20 vjet burg do t'më ngjallni nga këto dy pushkatimet dhe do t'më jepni edhe 20 vjet burg". Unë kom qenë ironik për atë që duhet jo për ashtu. Filloj me m'sha me nanë e me babë, iku dul përjashta. Priti se çka du me i thanë.

Burgu i parë më ka mësuar që ndaq bëhu frikacak ndaq ashtu, ndaq kshtu, ndaq rri karshi karshi ata t'kanë n'dorë bëjnë çka t'dojnë. Prandaj, nëqoftëse është puna me vdekë, vdek si njeri dhe pikë. Unë nuk e kom as s'kom firmosë apsolutisht asnjë...

Anita Susuri: Çka ka qenë qato tri aktakuza?

Agim Gjakova: Ato s'dolën fare se m'lirun, nuk dola në gjyq. S'kishin qenë argumente për gjyq.

Anita Susuri: S'keni pasë gjyq hiç?

Agim Gjakova: Jo, jo. Nuk kishin argumente, nuk kishin. Mirëpo arrestimi im, i Aliut që thashë, tronditi opinionin, jo vetëm ktu po kishte shku fjalë edhe në Shqipëri. Edhe atje kishte dalë emri që po arrestohen studentët shqiptarë në Beograd. Kjo ishte shumë thikë e mbrehtë. Domethanë për çka? Për çka? Pa veprimtari. S'mujshin me gjetë veprimtari. Nuk... shoktë e mi nuk flisnin këta grupi jem i pesëshes nuk flitshin me i ra pushkë nuk flisnin as unë për ata as ai për mu, të kuptohemi drejt. Me gjithë torturat që i bon edhe Aliut edhe mu nisoj, nuk folëm.

Shkoj nana ime, nuk e dishin që më arrestun që thashë në Gjakovë. Ajo tezja jeme që thashë që rrinte n'shpi, ajo u ngri e shkreta. Veç nuk i ra t'fikt kur erdhën me më marrë atë ditë. Ajo bile ato gratë e mahallës kishin thanë, "Kuku ai shkoj t'u fishkllu, nuk po ia ndin fare që po e shtijnë në burg" (qeshë). Shkoj nëna ime te Fadil Hoxha, koleg mësues. E priti. Tha, "Fadil", tha, "e kanë zanë Agimin". Se jo e kanë arrestu, e kanë zanë. Po m'tregonte nana pastaj. "U pre", tha, "i erdhi shumë shumë shumë rond. Shumë keq. Edhe nuk e di ku e kom a e kom gjallë a s'e kom gjallë a se s'po m'thonë asni fjalë".

"Zonja Emine shko në UDB", tha, "dhe lype djalit", tha, "edhe në emër temin", fjalë e fortë. Fadili ishte kryetar i Qeverisë së Kosovës n'atë kohë. "Shko në UDB dhe lype djalit edhe n'emër temin", domethanë jo veç ti vet po edhe n'emër temin. Mirëpo kryetari i qeverisë me të thanë për ni armik t'shtetit shko lype në emër temin ishte fjalë e fortë. "Se Fadil", tha, "e bom mullarin gjatë luftës", luftum me fjalë tjera, "po nuk ia lidhëm krytë dhe na u kalb mullari", "Jo", tha, "zonja Emine atë që deshëm e mrrijtëm". A din, kshtu pak Fadili.

"Nanë", thashë, "çka ke bo muhabet? Qysh i ke thanë?" Thashë, "A din që ju kanë ndëgju krejt?" "Po mor", tha, "bërtitshin atje në UDB krejt 'Hajde çka ke folë ti me Fadilin'" (qeshë). Ajo e shkreta plakë nuk dinte që ndëgjohen e përgjohen ato edhe Fadili përgjohej se çka flet. Kshtu. Tashi Fadili që thashë se e ndërprem aty, po kthehem edhe niherë. Erdhi Fadili. E kishin vendosë kshtu, kur krijova shoqatën i thashë Latifit, ni, i dyti ka qenë Latifi me t'cilin, Latif Berisha që e masakruan në Mitrovicë. Ndoshta ke marrë t'dhana për të. Merre këtë, qysh e pat' emrin, e Mitrovicës e ni shoqatës nuk e di se çka. Ajo m'i ka marrë do t'dhana për Latifin. Ni burrë i mirë e masakrun në Mitrovicë gjatë luftës tashi.

I thashë... isha ma i vjetër nja dy-tre vjet ma i vjetër. Kisha botu edhe ni vëllim me poezi. Tha, "Ti me u bo kryetar", "Jo, unë jom me qenë politik. Ty kryetar nipi i Hakisë që ka vra Milladinin", thashë, "ti do bohesh kryetar". Latifi s'ka bo kurgjo krye n'veti pa folë e pa bisedu me ne e tjera. Latifi më foli i pari, Ali Aliu i dyti, unë i treti. Se unë isha ky me njolla politike. Folën këta, folën këta. Unë isha ulë, Fadilin e kisha në krah të djathë, Kolë Shirokën ktu, Aliu ishte ktu, Latifi aty. Ai që po thom që s'e di kush ka qenë të partisë edhe s'e di a ishte Zekerija Cana m'duket që ishte edhe ai. Si sekretar e patën zgjedhë, jo të grupit po të shoqatës.

Kur mora unë fjalën, Fadili m'kapi dorën tha, "Ti Agim mos fol". M'njihte mu, familjen. Unë, "Po m'thu ti punë e madhe", a din. Prap m'shtrëngoi, "Ti Agim", tha, "mos fol". Latifi ma boni me kry, "Mos fol", edhe Aliu tha, "Mos fol", nuk fola. A e din që po t'flisja unë shkojsha përnjiheri. E dita. Pra, na lirun bashkë me Aliun. Gjatë kohës që unë isha në burg e ka thirrë Sekretariati i Punëve të Brendshme në Gjakovë, prej UDB-së, sigurimit dhe i ka thanë nanës, "Firmos ktu me bo kërkesë për shqyrtim shtetësie". Unë i lindun në Shqipni, do shfrytëzohej ky rast. Nuk është i lindur brenda territorit të Jugosllavisë.

Nana me babën kur janë ba regjistrimet në vitin 1923 nuk ka qenë m'u regjistru ashtu. Ani pse janë regjistru në kadaster ma vonë e tjera. Gjakova nuk shquheshin ato. Ma hoqën shtetësinë. Na hoqën. Meqë na hoqën shtetësinë më shpallën person të padëshirueshëm edhe m'çun në kamp përqëndrimi, "Do ta lëshosh Jugosllavinë. S'del ma i lirë n'tokë të Jugosllavisë", "S'më ka marrë malli hiç", thashë, "për tokë të Jugosllavisë, m'ka marrë malli për Kosovë". Më çun në kamp përqëndrimi midis maleve të Kroacisë. Kjo ish hera e tretë që më arrestuan.

Erdhi Laza, ai shefi i UDB-së. Ashtu më mori më futën me ni... i kishin dhanë urdhën. M'futën në ni, sa me i thanë asaj, ni kotec nën shkallë. Osht' në Gjakovë ajo godina e sekretariatit. Shkallët që shkojnë kshtu, n'kotec aty. Ajo mund t'ketë qenë e naltë nja ni metër e 20. Mund t'ketë qenë nja ni metër e 30 e gjatë. Mund t'ketë qenë e gjatë dhe vinte pak si hark nja sa janë shkallët? Ni metër. Me fjalë tjera unë s'mujsha m'u drejtu aty as n'kamë, as ultë, as n'shpinë. Që kur m'kanë nxjerrë mbas pesë dite s'mujsha me drejtu shpinën teme. Atë e kom provu zoti na rujtë që thonë, çfarë torture ajo.

U bë ni të ftohtë i madh. Erdhi me 29 prill erdhi... kur mbërrijmë në Beograd, me dur lidh e tjera e tjera 1 maji. Ishte 29 prilli vinte 1 maji. Në Fushë Kosovë treni ishte mbush plotë edhe nëpër shkallë njerëzit ishin kap për hekur, udhëtonin diku. Unë isha në... me tre milic edhe dy oficerë të UDB-së një anej një këndeje. Mos po arratisem, mos po bëj ndonjë kijamet. Qe ni shok i jemi i shkollës, sot është gjallë. Tre veta nga 35 që kemi qenë n'maturë vetëm tre kemi mbetë gjallë. Ismeti. "O' Agim o', a ke vend a?" Çka dinte ai i shkreti që më kanë arrestu. "Po", i thashë, "Ismet kom edhe të rezervum bile" (qeshë).

Hi në kupe unë atje pshtetem edhe boj gjum se kumeditë kur m'len me flejt këta mu. E disha se isha nën tokë që t'kom thanë. As s'disha as është ora, a osht' natë a dita, s'kishe dritë dielli. As s'më qitshin me shëtitë. Kishe çka kishe bo Ismeti nëpër atë kallaballëk dhe vjen aty edhe zgjate kokën dhe m'kqyrte. Me dhimbje ai i ishkrete, shok klase, shok mature disa vjet bashkë. Zbriti dikund Ismeti. Kur mbërrijmë në Zagreb, a, kurr m'rrijmë në Vinkovci, nga burgu i dytë si të thashë, m'kishte mbetë ni pagjumësi.

Ka qenë dy muj e gjysë tre muj e gjysë unë s'kom fjet pothuajse fare, ndoshta ni gjysë ore, nga torturat. Majsha disa kokrra, a din si pafta që janë të sheqerit, jo pluhun. Se ato të krijojnë energji, t'japin energji të përhershme, domethanë të shpejtë. Isha me durë lidhë. Në kupe këta po më çonin n'kamp nuk kishte ma tortura e kshtu. Veç thjeshtë. Po t'ftoftin... a me mangë të shkurta. Ftoft shkoj temperatura në zero gradë në tren. Ishin pshtjellë njerëzit. Kur i them ni femre kshtu si ti karshi, "A ka mundësi",

thashë, “n’xhep me mi marrë dy kokrra pafta sheqer”, thashë. Se s’mujsha me dur lidh s’kisha qysh m’i shti.

Ata milicët ishin knej, dy knej një anej. I tha, “A mundem?” Tha. “Po, po mundësh”. Nuk kishte ndonjë, nuk kishte hetuesina kshtu. Shtini duar në xhep i mori dy pafta. Nejti dhe nja dhjetë minuta siç dukej nuk u duru, unë djallë i ri i arrestum n’atë gjendje. Iku doli, shkoj në vagon tjetër. Nuk e duroj atë skenë ajo. Ka gjithkund njerëz. Kur mbërrijmë në Delnicëm në orën 04:00 të mjesit në maje të maleve Dinarike. Frynte veriu temperatura shkoj minus dhjetë, minus dymbëdhjetë, minus 15 gradë ku di unë. Unë me mangë të shkurta.

Më shtinë me ni podrum të milicisë kaq sa kjo dhomë {bën me shenjë tek dhoma e zyrës}. Dritare po pa hekur, pa xhama, dritare pa xhama, dritare pa xhama, derë knej podrumi. Atje poshtë kishte ni pllamë ujë. Hynte veriu nëpër ato dritare m’i hallakate britë. Unë fërkohu, mundohu me u mbrojtë. Në orën 04:00 t’mjesit m’kanë shti aty. Bre anej bre këndeje. Fut ni kamë n’ujë, uji i ftohtë, nxjerr. Si lejleku a din që rri me ni kamë. Mirëpo e pashë që ma mirë ishte t’i lejshe në ujë se sa e nxirrsha ngrihej meniherë. Pantollonat u bënte akull.

Si kom shpëtu nga ajo... deri në orën 08:00 pa dhjetë domethanë. Gati katër orë, pa gati hiç. Kur m’kanë nxjerrë m’kanë hypë në ni mikrobuz, apo autobus i vogël. Tanë ishin pshtjellë me pallto, me kapuçë, borë kish ra anej e këndeje, unë me mangë të shkurta. M’shikonin çfarë hajvani është ky, budallë. S’e dishin qysh. Shpëtova edhe nga kjo. Më çun në kamp përqenderimi. Aty mbaron historia. Kamp përqendrimi po m’thonë, “A don me t’qit’ në Itali apo në Jugosllavisë? Nuk del i lirë në tokë të Jugosllavisë”. “S’kam nevojë”, i thashë, “s’më ka marrë malli”. “Jo”, i thashë, “as ktu as aty”. Boj kërkesë... i kisha thanë nanës me shku, m’u kthy në Shqipëri. Ata ma vonun pak, m’lanë atje.

Po aty e gjeta ni familje në fillim, ni familje emigrantësh që kishin ikë. Të Hasit. Po djali i atyne kishte punu me motrën teme në Rilindje kshtuqë ata n’fillim pritën dy net sa u stabilizova. Më erdhi ma n’fund ajo. M’çun në Gjakovë s’më lan ata dy orë me nejt atje. Vetëm hallën e lanë. Shoktë e mi e tjera kurgjo. Rrishin 30-50 metra 60 metra. Ishin mbledhë, rreshtu krejt me pa film. Po m’qesin në Shqipni. Njerëzit që m’njihshin e tjera e tjera. Se kur u bo mitingu ajo leximi i poezisë u bo ni takim s’më lanë gja pa thanë sekretari i parë i komitetit të partisë së rrethit, sekretari i partisë së komitetit komunal e tjera. Si nacionalist si shovenist e tjera.

Më demaskuan nëpër lagje, në bllogje të ndryshme nëpër Gjakovë. Në vend se me më demasku ata ma rritën autoritetin. Njerëzit kur m’shihshin ma bojshin me kry {përlulë kokën}. Domethanë falemineres (qeshë). Kshtuqë u hap fjala po e qesin në Shqipni, po e përzan. Ishin mbledhë nga te dy anët. Ku është Hotel Liria në Gjakovë kish qenë sheshi atje, ktu ka qenë parku. Park osht’ tash po ka qenë ndryshe. Anej ishin mbledhë krejt. Ky e nali, shefi i UDB-së me qëllim gjipin aty edhe rrishin shikonin përseri. S’guxonte kush me u ofru, nuk i lenin.

Erdhi vetëm Kadri Kusari te gjipi aty. Aty m'lanë mu me ni officer, ata zbritën me pi kafe demek. Me qëllim t'caktun e lanë aty. Me pa çka po bohet. Erdhi Kadri Kusari tha, "Edhe këta po e provon a?" Thashë, "Po provoj edhe këta". "Ik more", thashë, "çka po don me pa n'sy t'gjithë këtij mileti", "Ik more punë e madhe". Ka qenë djalë trim edhe trim edhe me trimni shkojke kah pak naiviteti se s'duhej me bo atë, po nejse. M'qitën në Shqipni. Ajo pastaj osht' historia e dytë në Shqipni.

Anita Susuri: E në kamp sa keni qëndru?

Agim Gjakova: Dëgjo... A?

Anita Susuri: Në kamp sa keni qëndru?

Agim Gjakova: Me 29 prill, 27 maj s'kom nejt shumë ni muj, as ni muj. Me 27 m'kanë përcjellë në Shqipni. S'më lanë me nejt në Gjakovë as dy sahat. E vetmja që lanë me u taku me mu ka qenë halla. Halla që të thashë me burrë të pushkatun, me fmi që i rriti. A din çka m'ka sjellë si dhuratë?

Anita Susuri: Çka?

Agim Gjakova: Ma ka sjellë ni lugë. Lugë që hamë. Tha... i vetmi nip i katër vllaznve. Tha, "Saherë t'hash", tha, "t'më kujtosh". Simbolikë, simbolikë shumë ashtu. "Saherë t'hash", tha, "t'më kujtosh".

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: Zoti Agim bisedum për kohën deri n'vitet e '60-ta diku edhe m'tregut për krejt rrethanat si erdh deri te dëbimi që ju bë edhe shkur për Shqipëri. Po paraprkisht m'tregutë për prejardhjen e mbiemrit t'juj, pse e keni mbiemrin Gjakova deshtët me rrëfy.

Agim Gjakova: Po, ne folëm për deri vitet '60-të. Natyrisht unë bëra disa përmbledhje, një përmbledhje me disa aspekte sepse për t'folë edhe ma gjatë do t'shkonte shumë ma gjatë biseda, po kryesoret. Mbiemri natyrisht që ka qenë që ka mbajtë atëherë xhaxhai që vrau Milladin Popoviçin, Taha. Me siguri është nga mbiemri Ethem ose Tahir. Duhet t'ketë qenë dy vëllezër, gjyshërit e mi ose ku ta di unë s'i kom mbrri, s'i kom pa kurrë se... duhet t'ketë qenë edhe shkurt Taha, Tahir Taha dhe ka mbetë shkurt Taha.

Siç thashë, im atë futi ni mollë n'vesh në moshën 17 vjeçare në vitin 1919 u fut në qetë me Bajram Currin dhe shkonte të bënte Shqipërinë. Shqipëria e shpalli pavarësinë në '12-ten mbaroj lufta e parë, u kriju qeveria e parë mbrenda kufijëve që ia caktoj bota n'atë kohë që kanë mbetë edhe sot e kësaj dite. Ishte ma i riu në atë qetë të ushtrisë si të thom. Sipas zakonit të atëhershëm i hante t'gjitha shërbimet. Me shku me ble cigare, me mbushë ujë, ku di unë. Bajram Curri u emëru n'atë kohë

komandant i gjandarmërisë dhe njëkohësisht edhe zëvendës ministër i luftës. Nuk i thojshin ministri e mbrojtjes po ministri e luftës.

Shkoj me marrë këtë djalë që kishte bërë ni shkollë plotore në Gjakovë gjashtë vjeçare, që ta çonte në ni shkollë në Durrës për shkollë ushtarake ishte hapur. Nuk e gjeti aty, e kishin çu dikush shoktë e vet me ble cigare, ku ta di unë. Dhe, “Ku është ai Demushi prej Gjakovës”, Demush e ka pasë emrin baba. Nuk e gjeti dhe i tha, “Demush Gjakova”, e regjistroi dhe e çoj kshtu Demush Gjakova n’shkollë ushtarake. Baba shkoj n’shkollë ushtarake, mbaroj ni vit. Doli me gradën aspirant, nëntoger dhe shërbeu në ushtrinë e qeverisë të Fan Nolit. Nuk e ndrojoj mbiemrin. Kshtuqë na mbeti mbiemri Gjakova domethanë.

Zogu hyri si hyri, Ahmet Zogu, meqenëse ky ishte oficer dhe kishte kundërshtu hyrjen e tij e mori dhe e futi në burg. Mas disa kohe e thrriti në audiencë dhe i tha, “Ti”, tha, “ke qenë oficer, nuk je përzi shumë në politikë ke bo detyrën ushtarake”, tha, “unë kërkoj”, tha, se po ndërtonte ushtrinë Zogu. “Unë kërkoj”, tha, “që t’rrish me gradën kapiten në ushtrinë time”. Baba ia shfrytëzoi këtë rast. Ende nuk ishte bërë mret, ishte shkëlqesi, pra ishte kryeministër. I tha, “Shkëlqesi nëse doni t’më bëni ni nder më çoni në Shkollën Normale të Elbasanit”. Ia plotësoj dëshirën, shkoj në normale. Ato që i kom shpjegu pastaj që mbaroj dy vjet dhe u emëru msus Shkodre e tjera. Kshtu ka mbetur mbiemri.

Anita Susuri: E pikërisht për këtë arsye se edhe keni lindë në Kavajë, keni lindë në Kavajë prandaj edhe ju kanë kthi në ato vite në vitet e ‘60-ta. Po du me thanë me na tregu arsyen prej fillimit pse ju kanë dëbu pikërisht në Shqipëri?

Agim Gjakova: Po në Shqipëri jo, ata mund... kur më dërguan në kamp përqendrimi më thanë, “Në qoftëse don të nxjerrim në Austri ose Itali”, i nxirrnin tinëz i çonin në kufi, “Ikni, shkoni”. “Jo”, i thashë, “nuk du, nuk du”. Zgjodha t’më çonin në Shqipëri. Është një pikëpyetje edhe me shoktë, më kanë pyetur edhe shoktë, “Pse zgjodhe Shqipërinë?” Ose, “Pse shkova? A e dishe?” Në atë kohë fluturonte edhe bualli se kujtoni se Shqipëria ishte bahçe me lule se s’kishte kurfar’ komunikimi po s’e dishe se çka ka brenda. Po nëpërmjet radiove, fjalimeve e ktyre zbukurimeve kangëve e vallëve kujtonin se është bahçe me lule.

Unë në kamp përqendrimi takova disa të arratisur atje dhe ata përafërsisht ma dhanë pak a shumë figurën, pasqyrën se ç’është Shqipëria. Megjithatë, megjithatë unë zgjodha atë. Ka pasë midis shqiptarëve kshtu m’kanë propozu t’shkoja në Amerikë. Unë i thashë, “S’kom kurfar baze në Amerikë. Çka kemi?”, “I kemi njerëzit tanë?” Nejse, nuk pranova. Nuk pranova për arsye se nuk e gjeja vehtën me ni botë krejt t’hujë pa shqiptarë. Pavarësisht që e mësova që Shqipëria është po, natyrisht jo qind për qind po 70% ngat saj. Kshtuqë vendosa të kthehem në Shqipëri. Domethanë të riatdhesohem që i thojshin.

Anita Susuri: Dje na tregut që atë takimin me hallën që ka qenë vetëm ajo është leju me u afëru, pastaj ju kanë dërgu deri në kufi sigurisht?

Agim Gjakova: Po, pastaj më hypën në gjip dhe më dërguan në kufi dhe, “Dilni”, tha, “ik tashi”. Ishte zonë neutrale, ni brez osht’, brezi kufitar ktu osht’ posta jugosllave atje është posta shqiptare ushtarake që ruajnë kufinin. Është ni zonë neutrale që në kusur metra me thanë, edhe unë s’di sa. Hyra atje. Natyrisht mu më nxorën fishek pa ashtu, pa m’lanë që t’rrija në Gjakovë asni orë që t’mos takohna me shoktë e mi e tjera. Nënë edhe ni teze që ka nejt me ne i sollën të nesërmen, ata nuk i ngacmuan se plaka.

Kur hyra n’kufi ai roja shqiptare tha, “Ndal”. U ndala midis asaj zonës neutrale dhe u ula dhe po mendoja sa bukur do të ishte po t’mos kishte pushtet fare siç ish ajo zona as knej as anej (qeshë). T’mos kishe dikë m’i kry që t’rrin. Nejta nja 20 minuta aty derisa m’thirri ai. Tha, “Ku?” Thashë, “Po hy në Shqipëri”, “Hajde”, tha. Hyra aty, më shtijnë në postë ushtarake. “Ulu”, tha, “ktu”. Tashi po pritshin mas ni kohe gjysë ore erdhi ni oficer kapiten me nja pesë-gjashtë ushtarë t’vet. U ulën krejt. Mu ma kishin dhanë ni çantë këta shoktë e mi, ma kishin çu nëpërmjet hallës që thashë. E kishin mushë me karamelle, me çokollata ku po di unë. Ma kishin dhanë, “Merre me vete”, e vetmja ashtu.

Po erdhi, “Mirë se ke ardhë”. Hapën nja tri konserva. “O’ burra”, thashë, “pse po i hapni kto konserva”, konserva mishi. “Unë”, thashë, “vij nga kampi i përqendrimit”, me ni kusht dihet çka na kanë dhanë me hangër, s’po e përshkruaj atje. Unë”, thashë, “as qerekun e konservës s’e ha dot”. A din, për mikëpritje. Ju thom atyne ushtarëve nja pesë-gjashtë që ishin kshtu, ndëgjonin ata t’shkretë, s’kishin pa kosovar me sy. Njeri që vjen prej ni shteti tjetër. Thashë, “Merrni”. Zoti na ruajtë s’e zgatke kush dorën. I thashë, “T’lutem”, thashë, “thuj të marrin dhe t’mos turpërohen nga kurgjo”. “Mirë”, tha, “merrni merrni. Merrni”, tha, “se ka boll se unë s’i ha dot kto se m’i kanë dhanë”, thashë.

Nejse, kaloj. Muhabet kshtu muhabet të përgjithshëm. Po m’vunë me fjetë. “Ndëgjo”, tha, “në qoftëse ke nevojë me dalë natën kallxoj rojës”, tha, “mos dil pa tregu”, tha, “se roja mundet me vra se kujton se kush je”. Të nesërmen erdhi ni nën kolonel me makinë erdhën edhe nana me tezën të nesërmen me disa plaçka të trupit, s’morëm kurgjo tjetër. Na çun në Kukës. Në Kukës na lanë ni javë. Erdhi nji i sigurimit, nji nënkolonel i sigurimit të shtetit. Atëherë ende i kishin gradat. Bashkë me ni oficer tjetër, kapiten siç ish ai. Muhabet e tjera. “Ku ke dëshirë”, tha, “me shku?” Thashë, “Kom dëshirë t’shkoj në Tiranë dhe të vazhdoj studimet”, thashë. Mbajti shënime nuk tha kurgjo.

U largun ata, hajde me shku, “Ku do t’shkosh? Do të shkosh në Kavajë”. Kavajë në Kavajë. Sigurimi atje do të çonte. Me kamion e kshtu e tjera shkum, më çun në Kavajë. Kom pasë ni vajzë të dajës në Shkodër. Shkoj n’telefon edhe e marr... a më thretet para ksaj, më thretet ni oficer i sigurimit në Kukës aty në zyrën e tij. Ma kishte lanë ni karrige te dera. Kjo ishte si formë hetuesie tashi. Unë i kisha kalu hetuesitë e dreq e t’bir a kupton? Ai n’vend që t’më pyeste si je, qysh je a je mirë me shëndet? Kaloj kampe tortura e tjera. Ky filloj me m’pytë ku di unë se çfarë.

I thashë, “Pse”, thashë, “juve do t’ja u them unë kto?” Mbeti. S’i kish ndodhë që ti thonte kush këtij oficerit me autoritet në thojza. Tha, “Po ti”, tha, “do t’i thush në qendër”, “A do t’i them a s’do t’i them n’qendër është puna ime. Ju keni ndonjë gja tjetër?” “Jo”, “Hajt ditën e mirë”. Dola përjashta. Hajt udha mbarë. Kontakti i parë me sigurimin e shtetit në thojza. E marrë atë vajzën e dajës që e kisha në Shkodër, “Alo”, “Alo”, “Shërin si je?” Shërin quhej. “Mirë. M’falni kush jeni ju?” Thashë, “Unë të tregoj po ruju mos t’bjer t’fikt”, thashë, “ty”. “Unë”, thashë, “jom djali i hallës Minë”. Hallë e kishte ajo domethanë motër e babës.

Ulëriti me të madhe. “Po ku je? Në Kosovë?” “Jo, jo në Kosovë në Shqipëri”, thashë, “jom në Kukës”. Bam {onomotope} e ka lshu telefonin (qeshë), e shkreta. S’merrte dot frymë. “Po ku me kë je? Qysh je?” Kujtonte se jom arratisë. “Jo, jo”, thashë, “jom me nanën edhe me tezën”. Bërtit e ulërit. Ajo i nali në Shkodër të dyja kto, hallën, te dy hallat në të vërtetë. Unë shkova në Kavajë masanej.

Anita Susuri: E nana juu ka ardhë me dëshirë me juve apo edhe ajo, edhe ata e kanë largu? Nana që thatë.

Agim Gjakova: Jo natyrisht edhe asaj ia hoqën shtetësinë se kishte kshtu. I tha, jo për tezën, nana thonte, nana do vinte me mu kudo që shkoja n’fund t’botës n’fund t’botës. A tezja ajo m’ka rritë ç’është e vërteta. Nana n’shkollë, ajo n’shpi, analfabet pa kurgjo. Historia e saj s’du me tregu po ka qenë ni histori shumë e dhimbshme e tjera e tjera. Ka lindur dy fëmijë si drita mirëpo ka pasë rezus negativ. Me ni gjilpanë sot dhe kurgjo shpëtojnë fëmija grua krejt. Asaj i kanë vdekë fmitë t’vegjël, disa javësh, disa ditë. Fëmitë si drita i ka lind.

E i shoqi është martuar, i ka thanë, “Ti je zojë e madhe unë veç për fmi po martohem jo për tjetër”, siç ka qenë zakoni atëherë. I ka thanë, “Jo nuk rri dot”. Edhe pat’ gjetë si të thush strehën as te vllazërit as te motrat po te kjo motra ma e vogël e saj. Im atë ka qenë gjakftohët, nuk mërzhitej për kurgjo në kuptimin e ngushtë. Masandej vdiq edhe ai. I tha motra, motra ishte ktu e martune. “Teze”, tha, “rri. Për neve të mbajmë në pllammë të dorës. Çka ha ti çka shpenzon ti zoti na rujtë kurgjo hiç”, “Jo”. Unë i thashë, “Teze”, se i thashë se kisha marrë vesh që Shqipëria është pak jo fort mirë. “Teze”, thashë, “nuk e di se si është gjendja atje”, “Nëqoftëse”, tha, “s’ke ti bukë me hangër edhe unë nuk ha dhe do vë”.

M’kishte rritë ajo që fmi ma bënte mëngjesin. Nëna shkonte n’punë mësuese. Masanej kur u rrita ajo mbeti me ne, kshtuqë erdhi me ne. Në Kavajë më dërguan. Na dhanë tre mijë lek kur ishim në Kukës. Dy mijë e 400 lek u desht me pagu hotelin për ni javë. Gatuanin me ni far’ lloj vaji soje. Ajo tezja gjithë javën ka hangër vetëm pak bukë me kos. Nuk e duronte atë gjellë, at erë zoti na rujtë. Ishte mësu gatim krejt ndryshe. Bërtiste, “Kuku Minë”, Emine nana. “Kuku Minë era më myti era se jo mo gjella”, (qeshë). E shkreta. Kshtu puna më çun në Kavajë.

Atje më lanë me 27 maj 1960 kom dalë në kufi m'kanë qitë. Deri me 18 shtator kur kom marrë rrogën e parë na lanë me tre mijë lek që thashë na dhanë në Kukës. Tre mijë lek ish ni gjysë rroge mesatare. Rroga mesatare ishte diku gjashtë mijë lek. Tre veta në hotel me tre mijë lek çka t'bojsh? Po teza s'hante veç bukë me kos. I kishte shku çmimi kushedi çka sikur me pasë pasë tjera. As nana nuk hante. Dhe pastaj na dhanë edhe tre mijë lek dhe hiç ma shumë. Pra filloj t'bënin luftë nervash me mu si po reagoj unë tashi. A jom i Shqipërisë, a jom për Shqipërinë a qysh a tek. Ka qëlluar atje mas kampit e të tjera do sene që ta kaloj ditën me ni copë bukë me ni gotë dhallë.

Ju thashë, “Derisa vendosni se ku do t'më dërgoni më futni me ni punë kudoqoftë. Argat, me punu, ku di unë se çfarë nuk ka rëndësi. Nuk kom naj far”, “Jo, jo, jo, jo do t'vendosim”. Ma n'fund më vendosën msus. Mësues të gjuhës shqipe të kuptohet. Sipas shefit, jo shef ka qenë inspektor arsimit po ka qenë i malësisë ai. Malësisë së Shkodrës po ka qenë bagjanak me Zekerija Rexhën, domethanë njihej pak me kosovarët e kshtu. Kur është bo diskutimi në komitetin ekzekutiv të Durrësit ku me m'çu çka me bo me mu. Në kryesi të komitetit ka qenë ky i pranishëm po m'thotë tha, “U diskutu po”, tha, “si ta çojmë msus’ njëni prej atyne ‘kur ai nuk e din gjuhën shqipe, nuk e din gramatikën shqipe’”. E ke parasysht çfarë mendime ka pasë.

Ky i thotë, “Mirë mor’ burrë”, tha, “po supozojmë që nuk e din gramatikën shqipe. Po ky”, tha, “si student në Beograd e ka dhanë provimin e gramatikës së frëngjishtes”, tha, “e mson edhe shqipen”. Aty kanë mbetë pykë, s'dishin çka të thonin (qeshë). Domethanë e dha gramatikën e gjuhës s'hujë e s'pe din gramatikën e gjuhës së vet. U vendosa meniherë msus atje në Kavajë. Kavajë kaluan. Bon lutje unë që t'vazhdoj studimet Ministrisë së Arsimit dhe Komitetit Ekzekutiv të Durrësit. Duhej komiteti me ta miratu, po s'ta miratonte komiteti ekzekutivi rrethi i Durrësit ku përfshihej edhe Kavaja s'mund t'shkoje në studime. Siç ishte, që thashë, edhe ktu po u lirin '53-shin.

Bëj lutje vitin e dytë Ministrisë së Arsimit dhe Komitetit Ekzekutiv. Apsolutisht sistemi i kosovarëve si vorrët e shkijëve që s'nihet kërkush gjallë. As përgjigjet që kemi marrë lutjen as qysh as tek, hiç. Ata disa kosovarë që ishin arratisë i kishin pru në Kavajë më thanë që, “Ndëgjo”, tha, “neve na ka Ministria e Punëve të Brendshme në dorë. Kto institucionet tjera kto vendosin çka thotë ajo”, “E po mirë”, thashë. “Po është ni burrë atje në Ministri të Punëve të Brendshme që nuk të rren. Thotë po jo”, thashë, “Po mirë edhe unë ta di po ose jo. Do bëj studime ose s'do bëj studime. Ta flej mendjen dhe kurgjo kërkujt”.

Vij unë. Ka qenë muaji prill dhe e kërkoj. Ky quhej Skender Backa nga ni familje shumë e fortë e Skraparit. Zona, krahina e Skraparit. Me ni vlla gjeneral, me dy të tjerë në sigurim të shtetit. Me një që mirrej me organizatën e rinisë. Pesë vllazën. Pra familje shumë e fortë si të thashë. Ky ishte me peshë në ministrinë e brendshme, ish edhe anëtarë i kolegjiutit të ministrisë së brendshme. E kërkoj unë te oficeri i rojës atje. M'thotë oficeri i rojës, “Prit se do vijë”. Doli atje hyjmë në klub të ministrisë. Në klub të ministrisë ishin vetëm oficerat. Po meqë unë isha shoqëru me të, rojat nuk thanë gjo.

Muhabet, kafe porositi. Bisedë për Kosovën për gjendjen për kshtu e tjera. Dikur unë mas nja 20 minutave e pys thashë, “A mendon”, thashë, “byroja politike për Kosovën?” Këta shoktë e mi pastaj kur ju kom thanë thanë, “Si mor”, thanë, “e ke vu në dyshim byronë politike ti? Po byroja politike po mendon për revolucionin botëror e s’po mendon për Kosovën. Si e ke vu në dyshim?” U pshtet për karrike dhe po m’shikonte kshtu nja 15-20 sekonda po shikoheshim n’sy. “E di”, tha, “që mos me t’njoftë”, tha, “unë tashi t’i vëj hekrat t’çoj n’burg?” Mund ta bënte ai, ishte me peshë, anëtarë i kolegjiut. “Po edhe unë”, thashë, “sikur t’mos ma kishin përshkru se çfarë njeriu je dhe çfarë burri je kurrë s’ju kisha bo këtë pyetje”, “Çohu”, tha.

E kishte gjipin edhe venin besnik prej orës dhjetë pa 20 që jemi ulë n’kafe deri në orën 02:00 mas mesnate duke shku lokal më lokal duke pi ashtu dhe duke u përplas për Kosovën, për gjithçka, për trajtimin, për kto, për ato. “Pse s’na bini shkollë”, thashë, “a ma mirë luftohet revizionitmi jugosllav në mësimet e partisë”, të kuptohet, “me njerëz pa shkollë a me shkollë?” “Jo me shkollë”. “Pse s’na keni bini shkollë?” “Ke t’drejtë”. A di, unë e konceptova se ai ishte vërtetë burrë. Masanej ma ka tregu vet. Lokalet e tjera ka qenë pak ashtu, ka qenë Tirona, po flas viti ‘62, 1962 sa po i bje? 62 vjet përpara s’ka pasë kurgjo as Tirana.

“Jo”, tha, “unë s’muj. Kur je me mu”, n’thojza... kur u kthym, “Ndëgjo”, tha, “unë”, tha, “po ta kthej shpinën, ndaq me më vra vrahëm”. Masi ishim pedat kishim shku n’lokal të oficerave. Kishte thirrur orkestrën, “Hajde në Separe”, dhe mori orkestrën prej andej. S’guxonte kërkush me ia kthy fjalën, ishte me peshë. “Hajde”, tha, “boji muzikë ktij kosovarit se na ka ardhë prej Kosovës ky”. Ai knoj ni kangë i thashë, “Faleminderit”, dhe shkoj me bo muzikë atje. E të tjera e të tjera s’po hy, kshtu hallakamë. E kshtu se lokalet mbylleshin në 11:00 kemi përfundu në Dajt. Dajti ishte vetëm për t’hujë, s’guxonte kush këmbë shqiptari me hy aty se meniherë e thriste sigurimi dhe kush e di çfarë i bënte.

Tha, “Unë”, tha, “po ta kthej shpinën ndaq me më vra vrahëm”, tha, “t’kemi ndriku nga Amerika, t’kemi ndriku nga Europa, t’kemi ndriku nga Kosova, t’kemi ndriku Shqipëria”, domethanë kush je, çka je. “A dola”, thashë, “i kfejlltë?” Domethanë po të besoj tha. Tha, “Të kemi ndriku”, nga kjo, nga ajo. Tha, “Ne s’kemi vra mas shpinës”, thashë, “kemi vra drejt në lule t’ballit”, thashë, “axha jem ka vra Milladin Popoviçin”, thashë. Mirëpo ai s’ishte me variantin e Enver Hoxhës, këta ishin specialistë. “E dijmë e dijmë”, tha, “po mos e zë n’gojë, mos fol”.

Pjesa e Gjashtë

Agim Gjakova: Atë ditë i boni, edhe ni shok i jemi i boni letër kryeministrit. Erdhën 20 kosovar në universitet me shkolla, pa shkolla. Disa të shkretë e kishin lanë shkollën para dhjetë vjete që ishin arratisë. Erdhën qashtu. Unë, nejse, unë isha që thom unë kom bo 25 vjet shkollë (qeshë). Anej e këndeje e tjera. Erdhën pra. Mirëpo na mbeti ni lidhje me këtë oficerin. Ai e kishte pa dosjen teme, kishte pa... atë bisedën që bom na, unë e përplasha i thosha gjithçka që me bo me raportu ai çka kom thanë

unë hajsha burgim t'përgjeshëm ose kushedi çfarë. Po jo ishte njeri, e pashë që ai është njeri që bën muhabet, jo për qëllime po thjeshtë me vlerësu mendimet e njëni tjetrit.

Kishte student vitin e parë s'i dhanë do provime. Kur shkoj unë tre prej tyre i kishin bo valixhet gati, "Nisemi se nuk është shkolla për ne, ka kohë që e kemi lanë", "Shkolla për kënd osht'? Bash për ju", thashë, "osht'. Me kë ke provim ti?" Me filanin, "Ti?" Me filanin. "Ti?" Me filanin. "Unë", thashë, "ju rregulloj edhe nëqoftëse ju nuk përgjigjeni do kaloni n'provim". Unë i njëfsha ata profesora, i njëfsha si emra pastaj do t'ju thoja copë se ju thashë nja dy tjera.

"Ti", thashë, "nëqoftëse do të ndihmosh", thashë, "Kosovën du t'i bosh edhe kosovarët me shkollë pikë. Prandaj, ti do të kalosh këtë. Ky sa ka hi e ka ndërpre shkollën që dymbëdhjet vjet edhe hala nuk ka hy në", që themi ne, "në hulli të studimeve. E vërteta hyn kadal kadale dhe i mbaron studimet". Vjen prej të parit ti s'ke lexu që dhjetë vjet s'ke lexu shkencë tashti, dashtë e pa dashtë nuk mundesh meniherë m'u fut në asi... me këtë oficerin pastaj na ka mbetë miqësi edhe lidhje. Ai e dinte... m'u kriju situata e vështirë. U bo demonstratat e '68-tes në Kosovë.

Une mbarova studimet. Aty u njoha me mjaft me njerëz, me shokë, me profesor. Po në mënyrë të veçantë u bom miq e shokë me një burrë që ishte n'moshë si unë sot dhe me profesorin tim Skender Luarasin. Me të cilët dy-tre herë n'javë pinim kafe bashkë, rrinim në lokal, me profesorin tim. Sepse duke qenë në Kavajë, i çoj disa poezi në revistën Nëntori. Ni redaktor atje quhej Razi Ibrahim m'i mori, kurgjo. Nuk m'tha gjo, faleminderit. Bom muhabet kshtu. Po ma vonë m'ka thanë ni shok i jemi që ka vdekë, i Kosovës, i Llugaxhive kt qëi kishe mbaru shkollën bashkë me këtë redaktorin në Tiranë, universitetin.

I thotë që unë e mora shoqën Nexhmije dhe i thashë që ka ardhë një poet i talentuar nga Kosova dhe m'ka sjellë ni tuf poezish, çfarë t'bëj? Nexhmia i kishte thënë që m'i botu mos i botoni po mbajeni afër. Ato poezi nuk u botuan në Nëntori. Po ky po kalonte si redaktor në shtëpinë botuese. M'tha, "A din çka? Përgadite ni libër, vëllimin edhe bire", tha, "ta botojmë". Unë e përgadita librin. I vura titullin Dhe thonë se paqe ka n'botë. Se osht' edhe poema Dhe thonë se paqe ka n'botë, m'lidhej. A në të vërtetë çka bohet në Kosovë? Masakrime, vujtje e tjera e tjera.

Ky libër pati një jehonë t'jashtëzakonshme për dy faktorë. Faktori i parë ishte përmbajtja e tij kundër e tjera e tjera me temë të Kosovës kombëtare, me vujtje e të tjera. E dyta ishte se shkruhej ni poezi ndryshe ngaqë shkruhej në atë kohë në Shqipëri. Se shkruhej me rimë. Partizani shkon era fluron e ku po di unë kesi soji. Bile doli atje lajm kshtu midis studentëve, grupit letrat, ka ardhë ni Migjen i ri, për mua. Kshtu puna. Më pranun meniherë në... u bë plenumi i shkrimtarëve t'ri. U ngrit ni Panota që ka vdekë i shkreti. Tha, "Po Agim Gjakova, pse s'osht ktu?" "Jo", tha kryetari, "Agim Gjakova hyn me shkrimtarët e vjetër". Domethanë unë isha...

E merr Skender Luarasi dhe lexon dhe mbetet i mahnitur me këtë. “Mor’ ku osht’ ky ta takoj? Ku është?” I thonë, “Po e ke student”, “Si more e kom student?” “Po e ke student të degës së anglishtës”. Ai ishte i degës së anglishtes, dekani. I kishin thanë tashi, ai po dilte nga godina e fakultetit në oborr në shesh. Unë po hyja në oborr për të hy në fakultet. U pamë, u ndalëm. Filloj t’më shikonte si kalin kur do ta blesh, prej majës së kpucve, themrave e deri kshtu. Pyti, “Pse s’je ti 50 vjeç?” Se kishte mendu që jom shumë ma i vjetër unë djalë i ri (qeshë). Unë i thashë, “Se s’du t’jem”. Aty na mbeti ajo miqësia me profesorin masanej kemi bërë muhabete nga më të ndryshme e tjera e tjera. Tregoj histori të veçanta se s’ka nevojë për këto.

Ishte nga mungesa e informacionit 90% e popullësisë së re sidomos se ata të vjetrit edhe e dinin. Se ndryshe ishte me të vjetrit se ishin kontaktet gjatë luftës e tjera e tjera po t’ritë nuk dinin, s’kishin informacion. Historia e Kosovës përmbledhej në tre rreshta. Në Kosovë u bën kryengritjet 1910 dhe 1912 dhe kaq. S’kishte ma histori për Kosovën. Nuk dinin kurgja, as në gjeografi nuk flitej për Kosovën. E kshtu. Bile ni profesor duke thanë tha, “Rrafshi i Serbisë”, i thotë për Kosovën. Ngriten nja dy student i thonë. “Çka thu ti profesor?” Përleshjen atje bohen lomsh. Masanej u detyru profesori m’i reduktu se i kish marrë t’gatshme tekstet e Jugosllavisë.

Unë n’vitin e parë po m’thotë sekretari i fakultetit tha, “Agim”, tha, “do t’shkosh në rektorat, në korpus qendror”, “Pse?” Thashë, “Nuk di, më thanë t’kanë thirrë me shku atje”. Kur shkoj, “Çka?” “Hajde me dalë n’fotografi”, “Për çka ju duhet fotografia jeme?” “Ti do t’jesh”, tha, “midis 17 studentëve të shkëlqyeshëm të Universitetit të Tiranës”, “Hajde mirë”, thashë. Dola. Fotografia jeme atje n’ballin e rektoratit midis 17 studentëve. Unë ju thojsha ktyne, “Ju që s’dini kurgjo”, masanej fillun m’u kfillë pak se me kontakte me kshtu, “që s’dini kurgjo”, thashë, “ne nuk jemi vetëm për pushkë t’gjatë që thonë po jemi edhe për shkencë” (qeshë). Me humore kshtu.

Marova fakultetin u lidha me këtë nusen teme. Kjo erdhi ni vit ma vonë. Bashkë me ni shoqen e saj ishin arratisë me qëllim me ardhë me u ushtru, me u aftësu këtu në Shqipëri, me u bo luftëtare me u kthi në Kosovë me luftu për Kosovën. Po shyqyr i morën në hetuesi nja 20 e ca ditë po i prunë meniherë n’shkollë ato. Se kishin marrë edhe... na s’kishim ardhë hala ato i prunë. T’vllaun e saj unë e njifsha, e njifsha edhe këta larg kështu. Ka pasë qenë nxanëse e gjimnizit në atë kohë. Më kishin folë për të.

Po me vllaun e saj kemi qenë shokë, jo vetëm shokë të njohur po shokë të rezistencës, po e quj kshtu. E familjes Daci. I vllau i saj i madhi u burgos me Adem Demaçin e tjerë edhe e dënuan me gjashtë, shtatë, tetë vjet burg, nuk e di. Po kur i lirun këta në 1966 ‘67 që ra Rankoviqi nja tre-katër vjet burg i majtën këta. Që ishin dënu në ‘64-ten. A vllau tjetër, jo, jurist. Të dy kanë vdekë, të shkretë. Dhe i thashë, kur i takova... po m’thotë ni oficer i sigurimit, e njifsha aty, tha, “Kanë ardhë”, tha, “dy kosovare”. “Për njanën”, thashë, “e di, është filanja”. Se ma kishin përshkru çfarë mendimi ka. Se ajo shkonte n’shkollë me bluzë t’kuqe e me fund të zi, domethanë shenjat e flamurit tonë.

Bile i kishte marrë ai inati i profesori i serbishtës dhe donte ta linte, megjithëse kjo ishte nxanëse e shkëlqyeshme, donte ta lënte në klasë dhe t'ia hupte maturën. Nejse, s'po hi me shpjegu. Kur takohem i them, m'falni për shprehjen, me atë fjalën e keqe çfarë, me nder me thanë, "Keni ardhë ju në Shqipni?" T'u e ditë që... "E ti", tha, "pse erdhe?" Po ma pret kjo shoqja e saj. Thashë, "Jo unë s'erdha, mu m'çun me dhunë", thashë, "m'përzun", thashë, "se unë s'erdha". Nejse. Masanej mas nja disa kohe po i thom ksaj, e thrras këta i thashë, "Faleminderit që ke ardhë për mu", po i them ksaj. "Jo", tha, "s'kom ardhë për ty", "Jo", thashë, "ke ardhë për mu, e di këtë punë".

Nejse, u lidhëm me njani tjetrin dhe u martuam e tjera. Ajo mbaroj ma përpara. E emëruan jashtë Tiranës në Berat. Natyrisht e mbajta unë atje. Unë isha hala student se ajo e çun n'shköllë meniherë në '61-shin mu m'çun në '62-shin, si thashë, mas dy vjete. Atëherë erdhi puna emërimi jem. Emërimi jem u bo problem. Çka t'bojmë me këtë njeri? Agjensia Telegrafike Shqiptare më kishte kërku me emër. Kishe nevojë shumë për serbo-kroatisht. Dija frëngjisht, dija edhe anglisht. Me tre gjuhë s'kishe. Në agjensi s'kishe njeri me tre gjuhë. O' me ni gjuhë ose me ni gjuhë e gjysë. S'ka pasë. Rusishten, deri vonë rusishtja ka qenë.

Po s'guxonte kush me vu firmë për mu me m'çu në Agjensi Telegrafike Shqiptare. Që ta përmenda ata, ta thashë për Tanjugun. Atëherë shkon puna në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kërkesa. Më thrrret ky shoku që thashë, Skender Backa. "Ka ardhë", tha, "kërkesa për ty. Unë kom shokë", tha, "sekretarin e byrosë të komitetit të partisë". Se meqenëse ministria kishte shumë anëtarë partie nuk kishe vetëm ni organizatë po kishe disa organizata dhe kishe ni byro që të ktyne, që i drejtonte. Tha, "Kom shok dhe do t'ju them". Kshtuqë unë u emërova, i vetmi shqiptarë me firmën e Ministrisë së Punëve të Brendshme me shku me punu në Agjensinë Telegrafike.

Nga viti 1966 deri në vitin 1970 kom punu në Agjensinë Telegrafike Shqiptare. Redaktor përkthyes, kshtu ishte emërtimi. Tashi po m'vjen me lavdu vetën ashtu po unë kaniherë punojsha me dy daktolografiste. Punoja edhe në dy gjuhë shpesh. Ksaj i diktojsha ksaj ashtu, derisa shkruante kjo i diktojsha ksaj, kshtu në paralel. Kur ka plasë lufta arabo-izraelite për dy orë 27 faqe kanë shkru ato që ju kom thanë unë. Domethanë që merrsha raporte dhe lajmet që vinin nga bota dhe përmbledhjen e tyre.

Më dhanë, drejtori më dha mundësinë, jo mundësinë po kërkesën me shfrytëzu shtypin jugosllav me gjetë çfarë thonë, ku është, çfarë anomalie kanë, çfarë kontradikta ka midis republikave e të tjera e të tjera. Bile ma kërkuan ni Zëri i Popullit, gazeta, në Ministri të Punëve të Brendshme me shku m'i nxjerrë disa dokumente, disa sene e tjera. Kshtu. Ai metëm miq që thashë me këtë. Vinte më merrte e tjera e tjera. U bëm shok, shok. M'thoshte, "Ndëgjo, mos i beso jakës së kmishës sate", a din, jakës {prek jakën e këmishës}, "mos fol kërkund as në shpi tane", se ai e dinte që m'përgjojnë po nuk ishte sektori i tij, ishte tjetër sektor. Ka pasë sektore të ndryshme. "Vetëm", e kërkund tjetër natyrisht, "vetëm ktu në shpi teme na llafosemi", që thojnë ata, bojmë bisedë, "sepse ktu mu nuk m'përgjojnë". Ai ish oficer.

Kemi folë mar mrapsht me të. Jo për me prish Shqipërinë por për mangësitë dhe anomalitë që boheshi mrenda partisë në sigurim, në shtet, për trajtimin e kosovarëve, shumë sene. Ni ditë po m'thoshte, "Ej", tha, "a din që me na dëgju sigurimi", ky ishte vet anëtarë i kolegjiut, tha, "mu m'rjepin", tha, "po edhe ty t'pushkatojnë". Ai ma tregoj historinë e vet që ka hy. "Unë", tha, "s'kom hy për ideal ideologjik e m'the e të thashë. Unë kom qenë djalë 17 vjeç punojsha në rrugë për italianët thyjsa gur me çekiç me shtronin ni rrugë italianët. Erdhi", tha, "ai përgjegjësi italian", tha, "dhe nuk ma dha rrogën taman. Ia futa çekiç në kry dhe dola partizan. Kshtu kom dalë unë s'kom dalë për ideal as për kurgjo".

Po ishte djalë i shkathët, kishte luftu e kishte humb ni sy n'luftë. E njëfishin me shumë respekt. Jo vetëm mrena atje. Mirëpo u bo demonstratat e '68-tes për Kosovën Republikë. Lindin dyshimi, lindi dyshimi. Çka do t'bohet që kur t'bohet Kosova Republikë? Po bohen dy shtete. Kosova është tjetër, Shqipëria tjetër e tjera e tjera. Lindi, s'na duhen dy republika, s'na duhen dy kino studio, s'na duhen dy akademi, s'na duhen kshtu. Mjafton kjo që është në Shqipëri. Natyrisht që unë e kundërshtoja këtë. Dikur, nejshe, mas agjensisë që thatë mbarova, nejta katër vjet por u zuna me drejtorin, erdhi drejtori i ri.

Ai drejtori i vjetër ka qenë shumë i mirë. Ni burrë shumë i mirë. U zuna edhe ai m'përzun nga puna. Ai s'munet me m'pushu. M'thanë sigurimi, "Kur t'dush të kthejmë", "Jo nuk kthena mo aty. S'punoj me atë hajn, me atë budallë", ni tiranës, i trashë. M'çun në arsim, shumë mirë. M'çun mësues. E si mësues masanej m'thirrën se shkrova nja tre skenar filmash që janë xhiru. E mori Kino Studio pastaj, skenaristat atje. Kom punu edhe atje nja tre vjet. Si thashë me këtë... mirëpo këtë kur u bon demonstratat, ky nuk ishte... po m'thonte, "U bo ni diskutim", tha, "në kolegjiut", m'thoshte ky. Edhe unë thashë, "Edhe nëqoftëse ndonjë kosovar bon ndonjë gabim t'vogël nuk duhet ta arrestojmë për shkak t'politikës tonë që duhet ta mbajmë me Kosovën, ta kemi të hapur, t'i ofrohemi".

Mirëpo Enver Hoxha nuk e donte këtë punë. E hoqën nga sigurimi në vitin 1969, një vit mas demonstratave. Filloj ministria e brendshme me tund gjithë dosjet ku janë e ku s'janë, me gjetë kosovar tash se kush janë nëpër gjithë Shqipërinë. Meqenëse ky që thashë që kishte shprehë këtë u bo i papërshtatshëm ma me punu me kosovar. E morën edhe e emërun drejtor shkolle, me rrogë t'mirë, me makinë e m'the e të thashë. Po e hoqën nga pushteti, nuk kishte ma pushtet. Ky m'ka thanë, midis tjerav, po marr ni rast, "Ekzison", tha, "ni listë në ministri të brendshme që këta të burgosur nuk duhet të dalin kurrë nga burgu".

Unë du t'marr vetëm ni rast, se ka shumë raste. I dënuar me 20 vjet burg si kundërshtar i regjimit të socializmit domethanë, kundërshtar i regjimit komunist. I mbajti 20 vjet cik më cik ditët. U përshëndet me shokët e burgut a po merr vesh edhe tash po del n'liri. Sa doli në 70 metra masi doli nga kapja ku kanë qenë burgjet, e di unë ku kanë qenë burgjet se kom qenë aty. Iu ofrun dy oficera të sigurimit tha, "Ti je", filani, "Po", "Armik i popullit, kthehu", edhe dhjetë vjet tjera. Pra, njerëz që nuk duhej të dilnin kurrë nga burgu. Osman Kazazi ka bo 44 vjet burg. E Ademi mburret me 28. Thashë, "Le le ta kalon Osman Kazazi ty". 44 vjet burg ka bo ai i shkreti. Që nga '44 deri në '90-ten.

Pra e kom fjalën që e hoqën nga pushteti. Atëherë filloj gjyetia ndaj kosovarëve. Fut një, fut një tjetër, fut një tjetër, fut një tjetër. Mbi 70 e kusur kosovar janë fut krejt pa faj. U bë ni ankth i madh, ni ashtu. Nuk dihej ku po të qelte nata ku po të nxijke dita. Ka qenë ni Mërtiri me mbiemër ndihmës prokuror i shtetit. Mas 20 vjet që i shërbeu Enver Hoxhës e futi edhe Enveri atë n'burg. Se për çka e futi drejt e di. Ju kishte thanë ktyne kosovarëve që ishin n'burg, "O' e dishim që jeni t'pafajshëm po kishim urdhër të ju arrestonim".

Dilnim nëpër lokale, "Uuu qe ku qenka Agimi, e ka fut me pi kafe". Atë natë shkojshim e arrestojshim. Du me të tregu edhe ni arrestim tjetër. Kshtu puna domethanë i arrestun pa faj. E në atë u bë ni, ni, ni ankth i madh ndaj kosovarëve. Jo ata... ka pasë edhe kosovar që i bënë për veti, sigurimi i bënte bashkëpunëtor. Ata ishin tjetër punë. Po ne që ishim jo bash punëtor po kshtu. Du të tregoj ni rast që është shumë prekës. Ishte ditë e diel, unë... filloj servijimi 24 orë. A din kur thom 24 orë je i përcjellun nga agjentët e sigurimit. E ke në dosjen teme të cilën do flas ma vonë për këtë.

Ime shoqe, ishte ditë e diel fmitë hala s'kishin fillu shkollën. Njëni ishte katër vjeç djali gjashtë vjeç. Po lujshin n'oborr aty përjashta. Ajo po shtronte tavolinën për drekë. Po ashtu si zhurma kur lë thikën mbi pjatë çak çuk {onomotope} ose diçka, po edhe heshtja të tërheq vëmendjen. U bo ni qetësi, s'po nihej hiç ime shoqe. Kur ngrihem, isha në kamë me ni bukë ka qenë kshtu si tullë, me thikë n'dorë loti po i shkante në të dy sytë. Tha, "Çohu preje bukën", tha, "se s'kom fuqi". Domethanë ai ankthi. Tha, "Po nëqoftëse është puna për me na arrestu, ishalla m'arrestojnë mu se ti je ma i fortë dhe diqysh këta fmi..." Për ne nuk u bo mo jeta jonë, ishte çka do t'bohet me fmitë. Mirë që do na fusin neve n'burg po çka do t'bohet me fmitë.

Gjithë shqetësimi, gjithë... edhe ky ankth e kishte brejtë atë time shoqe, e kishte bo mos pyti. Ankthi çka do t'bohet me fmitë. Me vite të tana të përcjellun. Dal une ktu, dy oficera duke m'pritur atje dhe m'përcjellin mu kado që shkoj në mënyrë, me ta shti atë frikën, domethanë, me e pa që ty po të përcjellim se nesër ty do të arrestojmë. Ni shok i jemi poet që ka vdekë në orën dhjetë pa dhjetë po bohet gati me ra n'gjum se do shkoj nesër n'punë. Bam, bam {onomotope} troket dera. Hap derën dy oficer t'sigurimit, "Hajde me ne". Aty në gjip aty në burg. Ia hapin derën e qelisë, "O' firmos, o' hyn ktu", "O' firmos", këto që kemi shkru na ose, "hyn këtu". Dy fmi i kishte. Çka do bosh ti? A? Në atë situatë?

Anita Susuri: Domethanë ose m'u bo bashkëpunëtor ose me u...

Agim Gjakova: S'ish edhe punë bashkëpunëtori po deklarata të ndryshme. "O' firmos o' hyn ktu". Të gjithë ne mendonim që ishim jashtë të gjithë mendonim për fmi, s'kishte ma jeta jonë, jeta jonë u pa. U bo ni, ni, ni atmosferë e tillë e randë që nuk e ke idenë. Njerëzit hinin pa faj në burg. "Çka ke bo ti?" "Kurgjo". Ti tregoj edhe nja dy kosovar të tjerë se qysh janë tragjiko komedi janë hetuesinat e kto. Nga njerëz pa shkollë me përvojë edhe nga kriminel. Ç'kishte bënte ai i shkreti i firmosi. Mbas nja gjashtë javësh piu helmin. Mirëpo e kapëm shpejt e shpëtua. "Le more e dijmë". Shoku jem i ngushtë. Kemi bo muhabetë nga më të ndryshmet.

Ishte ni deklaratë kundër ni shokut tonë që ishte n'burg. S'kishin t'dhana për të. Unë i them ktij, Skenderit, "Ti e njef", thashë, "Myrtezanë", ka vdekë para dy vjete në Belgjikë ai, në Bruksel. "Ti e njef", thashë, "a ka bo?" "E di more e di", tha, "po s'kom pushtet ma". E kishin hjekë. Tha, "Po", tha, "rastësisht landën e tij e ka marrë njo i gjykatës që osht' shoku jem. Do bisedoj me të". Më thirri mas dy dite, "Hajde", tha. "Bisedova me gjykatësin e ka pa dosjen e tij o", tha, "'s'ka kufar' faji, kurfar' dokumenti po s'kom qare pa e dënu se m'dënojnë mu, po s'e dënova unë këtë m'dënojnë mu. Po do t'ja jap tre vjet", tha.

Minimumi ishte tre vjet se t'gjithë tjetrtë i kanë hangër dhjetë vjet, nantë ose dhjetë. E dënojnë tri vjet. Ky ishte, ky ishte deklaratë e shokut. Doli ky që po kalonte ky shoku jonë. Po i thotë ktij, "Hajde hajde hajde ktu", ktij që ia kishte lshu deklaratën. "Hajde ktu". Se i kisha thanë unë kshtu kshtu. "O' ti mik, o' ti shoku jem na jemi shokë siç kemi qenë. Shyqyr që shpëtove ti se unë e kisha t'shkrune që do t'shkosha n'burg. Punë e madhe", tha, "deklarata e kto s'kanë kurfar' vlefte se dihej ajo punë. Unë isha krejt pa faj dhe do të dënohesha pikë".

U bo procesi i Teme Sejkos dhe i morën dy kosovar, të shkret gjysë analfabet. Gjoja bashkëpunëtor të ktij po, komplot se e qujtën komplot, që i kishte dërgu UDBA. Dhe tragjikomedia. Njëni i tha, "Ty", tha hetuesi, prokurori, "Ty", tha, "t'ka dërgu UDBA me nëndetëse nëpër Dri". Merre me mend me nëndetëse nëpër Dri, veç me saju qisi sene. E zot i madh. E pytë njëni, ma kanë thanë vet janë edhe në mënyrën e shkrune me i marrë të shkrune dosjet e proces verbalet. I tha, "Fol", tha, "ti çka din për Teme Sejkon. Teme Sejko ishte ni çam, admiral që e futën n'burg, dihet komploti i tij. Ishte me politikë greke, grekët e futën. Nejse.

Ky tha, "Pasha zotën shoku hetues kurrë nuk jom konë n'qat' shehër". Nuk kishte ni kurrë emër Teme Sejko, a po merr vesh? Pra janë tragjikomedi ti s'e ke idenë. Po çka flet... e pytën shokun tem që erdhi m'takoj që e njoh atë kosovar që ka vdekë para pandemisë. Vdiq ktu në Kosovë, u varros në Kosovë se vdiq në Tiranë në të vërtetë. Nuk i bon fare hetuesi. Sa e mori hetuesi, "Po, po si urdhëron", mbaroj hetuesia kur tetë vjet burg. Ia nxorën ni dëshmitar. Që demek ky i ka bo agjitacion për ta bo për veti me punu kundër shtetit. I tha, "Mirë mor' burrë po", tha, "na s'jemi pa kurrë", ktij dëshmitarit. "E di", tha, "nuk jemi pa kurrë po unë e di që ti je armik" (qeshë). A kupton ti? E të tjera.

Njëni, njëni tha... janë tragjikomedi nuk e di idenë. Tha, "Ky", tha, "ma ka vra djal", "Po ku e more vesh ti?" Tha, "Ma tha djali". Djali i vram ia kishte thanë atij. Pra, e kom fjalën ka qenë ni situatë jashtëzakonisht e randë. Unë një armik shumë i rrezikshëm i partisë dhe i shtetit i servijun për 20 e kusur vjet përpara. U kriju autoriteti i trajtimit të dosjeve të sigurimit edhe e kërkova dosjen para katër vjete ka qenë kjo punë, tre vjet e sa para pandemisë. Ma përgaditën ma dhanë. Kërkoj... më tha ai që ma përgaditi, "Duhet kërku", tha, "drejtoresha..." është drejtoresha e atij instituti. Tha, "M'u taku me ty", "Pse more", i thashë, "u bo marak drejtoresha", se kto ua thashë por po ua përsëris. Nuk e di. Dolëm u përqaftim e tjera.

Tha, “Si ka mundësi”, tha, “ato që ti ke n’dosje, njerëzit për të tilla, argumente të tilla, fjalë”, tha, “ose janë pushkatuar ose janë dënuar me burgim të përjetshëm. Ty”, tha, “nuk t’kanë fut as ni ditë në burg”, tha, “osht’ enigmë për ne si ke shpëtu ti? Si ka mundësi kjo? Kur njerëzit”, tha, “nëqoftëse ka hy në lokal s’ka gjetë kafe, s’ka kafe sot. Pse s’ka kafe ka bo piskam e kanë fut n’burg dhjetë vjet. Po bon agjitacion e propagandë e kundër partisë së shtetit”.

I thashë, “Drejtoreshë, mu nuk m’ka shpëtu perëndia se s’e besoj, nuk m’ka shpëtu as ndonji i madh që me thanë hajt ta falim këta. Mu m’kanë shpëtu”, thashë, “vllazërit e tu e të mitë”, thashë, “në Kosovë. Unë”, thashë, “biri i Demush Gjakovës. Kryetar i këshillit të parë të Këshillit Nacional Çlirimtar i dënuar në vitin, në dimrin e vitit ‘41-’42 në Gjakovë. I arrestuar nga Italia fashiste dhe i burgosur dhe me demonstrata”, po i thashë kto m’duket?

Anita Susuri: Jo, jo.

Agim Gjakova: Nuk i thashë.

Anita Susuri: M’keni tregu mu.

Agim Gjakova: Edhe u bo demonstrata për lirim e tij gjithë qyteti u mbyll me dyqane me krejt. U ndodhën italianët në pozitë shumë të vështirë e nxorën ushtrinë nga kazerma, u përdorën armët shtijnë e vranë Sani Nushin e plagos disa të tjerë, u rrahën zunë e kë nuk zunë. Mirëpo u detyruan që ta lshonin se u hap në gjithë Shqipërinë në atë kohë në opinionin. U detyruan ta lshojnë italianët. Mbasi e mbajtën keq në burg edhe pak shëndet ligë ka qenë edhe vdiq në shpi.

Pra, “I biri i ktij dhe nipi i Haki Tahës”, thashë, “që vrau Milladin Popoviçin. I arrestum e i torturum tri herë në Beograd për qëndrimin e tij dhe për veprimtarinë e tij në krijimin e shoqatës të studentëve shqiptarë ku s’kishin as serb as malazez as kërkush tjetër. Vetëm shqiptarët kishin shoqatë jashtë shtetërore. Du t’bëj ni pyetje, a do ta besojnë ata vllazërit edhe të tu edhe të mi që janë profesor, janë doktor shkencash, janë rektor, janë dekan fakultetesh, marrin pjesë në simpoziume ndërkombëtare. A do ta besojnë ata që Agim Gjakova ka ardhë me prishë Shqipërinë? Jo”, thashë, “nuk besojnë”.

Kushdo që ka ardhë ose m’ka taku ose m’ka çu selam nga këta. Po edhe njerëz të panjohur po merrnin emrin tem si adresë e tjera dhe më kërkonin. Unë nuk kom pyetë për sigurim dhe kom dalë edhe i kom taku njerëzit domethanë në sy të oficerëve të sigurimit. Që ziheshin, ziheshin në veti si ka mundësi ky na sfidon. Ishte sfidë, sfidë për sigurimin e shtetit. Se s’guxonte kush pa leje pa kurgjo të shkonte t’i takonte të hujtë, e sidomos kosovarët. Lindi problemi... do hapej pak dera se s’kishin nga ia mbanin.

U diskutu me të gjithë sekretarët e parë të komiteteve të partisë së rretheve që kosovarët janë të molepsur nga ideologjia revolucioniste, borgjeze. Prandaj ata kur vijnë do ta përhapin këtë lloj

ideologji. Prandaj, ju sekretarët duhet t'keni shumë kujdes, t'jeni vigjilent të shikoni këtë punë. E të tjera e të tjera çka të them. Sot kanë dalë shumë sene s'po hy unë t'i përsëris.

Pjesa e Shtatë

Agim Gjakova: Siç thashë filloj servijimi total. Si thashë e kërkoja dosjen e mora. Dosja jeme ishte 1128 faqe, e kom. Isha bashkë me ni t'burgosun, shok temin që kish mbajtë dhjetë vjet burg. I dënun dhjetë vjet po nuk e lshuan pas dhjetë vjete e mbajtën edhe 60 ditë plus. Nuk e lshuan kur mbushi afatin. Unë tallesha me të i thosha, “Kto i ke, 60 ditë i ke kamatë për ato t'burgut, ato dhjetë vjet”, (qeshë). Tha, “E di dosjen kush e ka nga ju? Agimi”, tha, “e ka ma të madhen edhe pse s'ka qenë n'burg”.

Në dosje ka aty që Shqipëria e la Kosovën në vitin 1944 në dorën e shkaut. Që Enver Hoxha nuk është kujdesur për popullin e Kosovës. Që kosovarët nuk trajtohen mirë në Shqipëri. Që edhe nëqoftëse ne kosovarët ndërmarrim diçka, Shqipëria nuk na ndihmon por na lë neve e tjera e tjera. S'po hi tash me i thanë ato që i kom n'dosje. Pytja e parë thanë, “Si ke pasë mor' ti çfarë guximi? Çfarë budallai ke qenë që ke firmosë me shkrimin tënd këtë letër dërgu partisë?” Ishte letër dërgu. I thashë, “Po vjen ni periudhë kur mu m'u bo rrafsh e gjithë dynjana. More as s'shifsha as kodra, as male as kurgjo hiç. Le ta bojnë pushkën top, çka t'kenë qef. Unë do t'i them të vërtetat”.

Natyrisht nuk m'kanë arrestu. Si të thashë ka qenë opinionin. Vjen në mitingun e poezisë që mbahej në Gjakovë kanë ardhë vit për vit kanë ardhë... u hap dera nga viti '70 e knej. Vjen ekipi i parë me sekretarin për letërsi Lazar Seviqin. Që ishte hera e parë që po vinin nga Shqipëria ishte i pranishëm Fadil Hoxha, Xhevdet Hamza sekretar i punëve të brendshme. Krejt autoritetet e vendit. Në sallë atje ngrihet ni nxanëse atje. E kom taku ktu. Tha, “Shoku Lazar”, tha, “duhet të dijmë”, tha, “si e kemi bashkëqytetarin tonë Agim Gjakova? Ra bomba”, tha buuum {onomotope}. Ni qetësi e madhe.

Këta pushtetarët, Fadili jo se Fadili ndryshe. Këta pushtetarët kqyrne vetën, si del ky emër i ktij njeriu që i ka kap buletinin i kuq jugosllav si armik. Pra, guximi i asaj vajze. Nuk i kanë bo kurgjo. Lazari mbeti. S'e kish pritë që mund të bënte ndokush pyetje për këtë armik të rrezikshëm të Jugosllavisë. I thotë, “Ost' mirë me shnet”. E gjeti ni përgjigje sa për ta kaluar radhën. E kur vjen Xhevahir Spahiu, shok i jemi i ngushtë, skraparli [nga Skrapari] edhe ai. Kishte shku n'shpi teme ku kom nejt në Gjakovë, kishte marrë ni copë tjegull, çeremide edhe s'di se çka tjetër edhe m'i pruni, “Kujtim nga shpija jote”, thotë, “i ke”.

Unë po rri, po m'kqyrë. “Fol mor' Xhevahir”, hiç, hiç. “Fol mor’”. Shkoj ni minut veç po m'kqyrë, veç po m'kqyrë, po m'kqyrë. “Fol mor' çka ke?” “Pse nuk je”, tha, “ti pejgamber?” “Pse”, thashë, “unë pejgamber?” “Po”, tha, “ata shoktë e tu ty po t'mbanin”, tha, “pejgamber çka di unë. Nuk kishe njeri”, tha, “t'mos përmendnin. Krejt shoktë e tu të mbanin në pëllëmbë t'dorës”. Tashi këta krejt i kanë, kanë

qenë të detyrun me raportu gjithçka çka kanë ndëgju, çka kanë pa në Kosovë dhe vlerësimi që kanë bo për mu.

Do të marrë ni shembull tjetër, se ka shembuj boll. Ne ngriheshim në mëngjes në orën 04:00 të mëngjesit t'shkonim t'zinim n'radhë për të marrë dy litra qumësht dhe a i merrshim a s'i merrshim varet sa vinte qumësht dhe sa ishte radha. Dolëm që ka qenë ni profesor i gjeologjisë në fakultet. "O", tha, "Agim", tha, "kom qenë në Kosovë po do rrinim", tha, "ka me t'thanë diçka", "Po mirë". Marr unë qumësht dhe dal. "Ndigjo", tha, "isha në Kosovë, mbajta leksionin kur dola", tha, "m'u ofru ni vajzë", "tha, "profesor", tha, "mos e njihni rasisht Agim Gjakovën?"

U ktheva. "Po ti", tha, "ku e njeh?" Fjalët e saj. "Agim Gjakovën e njeh gjithë Kosova" e atyne viteve. Domethanë rinia... tash janë plakë këta, janë bo kah 50-60 vjeç. Ktij i bon përshtypje. Krejt këto, këta janë detyru ashtu... prandaj edhe shoktë e mi m'thonë, "Ti ke shpëtu pa u arrestu sepse ti ke qenë i njohur totalisht. Jo veç si familje jo vetëm në pushtet që Fadil Hoxha e të tjera, gjithë këta struktura pushtetare. Po ka qenë edhe i njohur në midisin shoqëror. Po ti ke pasë shokë Dervish Rozhaja rektori", jo rektori i parë, "rektori i Universitetit të Prishtinës".

Na shok në Beograd punonte për doktoraturë shkojshim ia mbledhshim bretkosat se ka bo... ia caktun temën me bo disetacionin për nervat e bretkosave. Ku di unë se çfarë. Po rektori tashi, shoku jem i ngushtë vie atje takohemi. Kto kanë lanë... edhe thotë, "Ti vetëm se ke qenë i njohur ke shpëtiu se përndryshe edhe ti e kishe hangër". E që kom qenë i njohur do të thotë ashtu. Çoj unë vëllimin me poezi, Rrënjët përtrihen, dhe ma kthejnë pa botueshëm me katër, me pesë akuza shumë t'rande. Kto akuza t'çonin n'burgim të përjetshëm ose 25 vjet burg kshtu me siguri.

E para, vëllimi është kundër ideologjisë së partisë, kundër politikës së partisë, e ke edhe atje. Kundër ndërtimit të socializmit hermetik dhe luftë nxitës. U bo diskutimi unë hala s'pe disha tamon. U bo diskutimi në lidhjen e shkrimtarëve e drejtonte Dritëro Agolli, kryetar, anëtarë i partisë, komunist. Nuk pyste ai, nëqoftëse është puna për Tiranë ktij kokës i binin kokës. Merrnin pjesë shtëpia botuese që kishte çu këtë raport. Nuk e di ishte ba në plenumin e komitetit të partisë ishte folë për mu si reaksionar, kumeditë se s'ko mpasë veshë po masanej ma bonë që osht' folë për ty po se çka osht' folë nuk më thanë. Bashkë me tre redaktor dhe ni tjetër i ministrisë të kulturës.

Ktej ishte Dardan Shapllo sekretar, m'fal, Lazar Seliçi sekretar për letërsinë, Dardan Shapllo sekretar i organizatës së partisë, unë, unë isha afër drejtorit dhe Vehbi Bala profesor në Shkodër që kishte bo ni recension supër pozitiv për vëllimin se jo i mirë po super i mirë. U lexun nga Than Nosi drejtori këtu pesë akuza. Kur tha, "Luftës nxitës", "Pse mor", thashë, "kujt kom dashtë m'i shpallë luftë unë", thashë, "Zanji Barit a?" Gjuha jeme ka qenë, ishte bo rrafsh dynjana nuk pytja ma. "Jo", tha, "ke dashtë me na shti në sherr me Jugosllavinë", "Pse more unë qenkam aq i fuqishëm që muj me shti n'sherr dy shtete", thashë, "a je n'vete ti apo s'je?" Nejse.

E u diskutu atje dhe s'pranova kurgjo. U ngritëm për drejtorin. "Ti", tha, "ke këtu nanën poezinë për nanën që mirret sikur ne jemi tutor edhe për Kosovën e në politikë kjo nuk lejohet". "O' ti Dritëro", thashë, "unë nuk e bëj nanën nga katyni yt more Kulas nga e ke ti. Unë e kam nga Gjakova", thashë, "e nga Gjakova do ta lë edhe në poezi edhe në shkrime gjithkund". Jo, po, jo, po. Nejse, nuk u bo. Mas dy dite m'thrret Dardan Shaplllo. Ka qenë njeri i mirë, kemi bo muhabet edhe jashtë protokollit. "Agim", tha, "na thirri", tha, "Ramiz Alija", anëtarë i byrosë përgjegjës për sektorin ideologjik në byro politike. Dhe na tha, "Merreni dhe kritikojeni", tha, "ju lidhjen e shkrimtarëve po mos harroni se ai e ka vendin e vet në letësi".

Prandaj thashë Dritëro ishte i moderum se ai si komunist t'çonte n'vorr në thojza. Këta e lavdërojnë se nuk i kanë njoftë njerëzit qysh janë. E kom fjalën që ishte, ishte nifar' nifar' atje në byro e tjera ishte që s'ma kanë thanë po me hamendje bisedë me shokë tha, "E kanë pasë pak të vështirë", tha, "me ty. Nuk e kanë pasë shumë të lehtë", tha, "me të arrestu. Sepse do bonte jashtëzakonisht përshtypje shumë të keqe në Kosovë ajo punë. Se ty t'kanë njoftë të gjithë". Ne kemi qenë 60 student, unë e krijova shoqatën. E kom fotografinë, duhet ta kem këtu n'telefon.

Anita Susuri: E shikon pastaj.

Agim Gjakova: Fotografinë kur kom shpalos ato për krijimin e shoqatës, nuk e di a është n'libër aty.

Anita Susuri: Mundemi pastaj me shiku.

Agim Gjakova: A?

Anita Susuri: Mundemi me shiku ma vonë.

Agim Gjakova: Mirë, çkado t'i çoj fotografitë. Dhe pra e kom fjalën aty tha, "T'ka shpëtu..." Çka s'ka aty në dosje 104 emra oficerësh, drejtorish, oficer të sigurimit, operativ të sigurimit të cilët janë marrë drejtpërdrejt ose tërthorazi. Kur them tërthorazi, e kishin pytë atë të Korçës, sigurimit të Korçës, ai jepte përgjigje, "Ne ktu nuk kemi ndonjë t'dhanë për këtë person", për Agim Gjakovën. Trajtimi qysh e kanë qujtë ata A2. A2-shi janë ata që janë ma t'rrezikshmit që duhet m'i pa. "Agim Gjakova", që thashë, "doli nga shtëpia", në filan ore. M'i kanë përshkru edhe andrrat. "Doli nga shtëpia në orën 07:21 minuta. Kaloj kësaj rruge takoj Anitën folën diçka shkoj n'punë u kthy në orën 09:32 në shpi". Thashë nuk m'i kanë përshkru edhe andrrat se gjithë ditën në dosje kshtu.

Prandaj, ajo që përshkrova të ime shoqe edhe atë përshkruanin. I kom kërku dosjen e saj s'po ma japin, nuk po ma japin. Do shkoj do kërkoj. Rreth 50, 40 e se di sa bashkëpunëtor sigurimi janë ngarku me më mbajtë mu, domethanë me pa, me m'surveju, me folë, me nxjerrë fjalë e të tjera. Po ka pasë edhe njerëz të ndershëm prej ktyne. Dal ni ditë unë në Tiranë dhe kërkoj ni kosovar nga Durrësi. E shoh pak si fytyrë kshtu, "He mor", thashë, "ke naj hall? Çka ke?" "Jo, jo", tha, "jo. Hajde te pijmë ni kafe",

“Çka ke?” Thashë. “Jo, jo”, tha, “hajde ta pijmë ni kafe”. Hyjmë pa anej këndeje. “Më ka thirrë”, tha, “sigurmi dhe m’ka thanë me ardhë me nejt me ty dhe me të nxjerrë fjalë. Tash ti mu m’thu çka me thanë mor’ burrë unë?”

Me ju thanë jo qysh ti jo? Çka domethanë ti s’e kryen detyrën që të ngarkon partia e tjera e tjera. Kumeditë hajde edhe ti shko n’burg pra. “Çka me thanë”, tha, “unë tashi ti kallxom?” I thashë, “Thuj që kemi bisedu për femra, për sport” (qeshë) se s’ka pranë me hy anej në politkë”. Pra, ka pasë edhe kshtu njerëz. Ka pasë edhe këta. Ka pasë edhe asi që dashtë e pa dashtë i kanë shti. Janë nja dy që janë atje, figurojnë po s’kanë kurgjo nuk kanë dhanë asni deponim as. Osht’ edhe ni tjetër që e kom ndihmu me gjithçka more materialisht more... e mora vesh ma në fund po s’e disha që është aq i poshtër si të thush. 84 denoncime janë në dosjen teme, nuk e ke idenë e të tjera e të tjera.

Anita Susuri: E ju thatë që keni punu edhe në Kino Studio? Keni pasë do punime pastaj...

Agim Gjakova: Unë para se me shku në Kino Studio me regjisorët i shkrova tre skenar, u bën filma. Në Kino Studio shkova, më morën si skenarist. Kom bo nja dy-tre skenar po nuk janë pranë që t’xhirohen. Në ni skenar u hodh poshtë, i pa përshtatshëm. Kur dolëm m’u ofru Piro Milkani, regjisor, regjisor i mirë. “Agim”, tha, veçmas, “nuk mund t’i xhirojmë”, tha, “na këta skenar”. Me fjalë tjera prekshin politikën e partisë pak atë rregullin. Unë i bëjsha skenar lirik, skenar me të vërtetë, skenar me shpirtin njerëzor jo me {ngrit dorën boks lart} urra përpara (qeshë). S’kanë vlera. Unë s’mujsha me bo asi skenarësh. Nejse, pastaj dola u largova nga Kino Studio. Dola në profesion t’lirë nja tre vjet edhe pastaj në pension nga viti ‘91-’92 në pension.

Ime shoqe Naime Daci nga familja Daci. I ati një hoxhë po patriot dhe atdhetar i ekzekutun në dimrin e ‘44-’45-tes. Nuk e dijmë as ku është ekzekutu as ku e ka vorrin as ku e kanë çu as se si. E mbetur jetime pra katër vjeç, nga ‘41-shi e lindur pra katër vjet. E rritur me thoj të durëve që thonë të njerëzve që kanë kontribu. Njanëse e shkëlqyeshme. Një fëmijë, një e re që e guximshme që nuk pyste fare, mbante simbole dhe flamurin kombëtar. E vetmja ndoshta në shkollën në gjimnaz në Pejë duke pasë gjithmonë ni fund të zi edhe ni bluzë t’kuqe. Shkoj të studionte në Sarajevë për dy vjet.

Bashkë me ni shoqe si atdhetare e mbushur mendja që duhet të aftësohemi për t’luftu për Kosovën arratisen për Shqipëri me qëllimin që të aftësohen, të mësohen se si duhet dhe organizu rezistenca dhe të ktheheshin në Kosovë. U njohëm. Unë e njihsha, vllain e saj e kisha shumë shok që thashë. Atë e njihsha nga larg. S’kemi pasë ndonjë takim naj gja kshtu, kemi folë niherë, dy herë rasishëm. Por ma kishin përshkru si, që thosha unë, me pak humor ku je moj revolucionarja ime e vogël se ishte shumë e, me qëndrim para rojë për qështjen kombëtare. Me siguri ndikonte edhe pushkatimi i të atit edhe familjes e tjera.

U martuam, u njohëm e u martuam natyrisht. Kishim një marrëdhënie ma shumë shoqërore dhe vllazërore si dy pjesëtar të një pjese t’kombi. Pra, si dy kosovar sesa si burrë e gru, në kuptimin e

ngushtë të fjalës. Bisedat tona nuk ishin çka ka n'shpi e qysh, ku po di unë se çfarë po ishin biseda qysh bohet, qysh mund të ndihmohet, çka mund të kontribojmë për Kosovën, çka mund të bëjmë për anën kombëtare, si është situata në Shqipëri, si është... e të tjera e të tjera. Kur u ngujun minatorët e Trepçës ajo erdhi e ndëgjoj këtë lajm dhe u përvaj, i shkun lotët. Do të thotë na me trup ishim atje, me mendje me shpirt ishim këtu.

Unë bile kom shkru ni poezi për atë dhe i thom, “Merrni lotët e gruas sime që të shuani etjen atje në galeri ku jeni”, domethënë në këtë kuptim. Pra, ni njeri shumë e aftë sa i përket gjuhës. Madje në ni rast i bëri ni pyetje profesor Selman Rizës që s’ia kishte bo kërkush. Selman Riza ka qenë shok i babës edhe me të rrisha herë pas here dhe m’thotë, “Ajo e fejuara”, se ishim fejuar hala student, “e fejuara jote”, tha, “m’ka pshtet për muri”, tha, “m’ka bo ni pyetje”, tha, “që unë nuk i dhashë dot përgjigje aty për aty dhe i thashë do t’jap përgjigje nesër. Dhe mora studiova mirë e mirë ia dhashë përgjigjen natyrisht”. Pra, shumë e aftë për gjuhën.

Mbaroi universitetin si thashë e la ni vit pa punë pastaj u emëru mësuese. Ajo nuk e donte arsimin, përtonte me korigju hartime e tjera. E donte ni punë... “Punoj mrena tetë orëshit dhe pastaj du të merrem me puntë e mija të shpisë, fmitë e tjera”. E caktun redaktore në Shtëpinë Botuese Naim Frashëri. Shqipëria kishte vetëm ni shtëpi botuese atëherë. Natyrisht e përqendruar siç ka qenë sistemi dhe kishte shtatë redaktor. Një ndër shtatë redaktorët ishte kjo. Mirëpo ishte, siç thashë, shumë e zonja për gjuhën. Por, mendimi i përgjithshëm edhe ni pjesë e t’madhe e intelektualëve ishin që ne kosovarët nuk e dinim gjuhën. Siç të tregova për gramatikën që s’e disha gramatikën e shqipës e tjera. Kishte ni dyshim ashtu.

Redaktimi i parë ishte me ni përkthyes nga gjuha frënge. Ajo ka pasë punu frëngjisht nja dy vjet, dinte pak a shumë. E merr e pa e lexon përkthimin dhe e thret. Ajo me nifar’ mendjemadhësie, kosovare kjo. Kjo nuk i bënte fjalë. I thotë, “Ky paragraf ti e ke përkthi me fjalët shqip por e ke ruajtë konstruktin frëngjisht. Ne duam që konstrukti t’jetë sipas sintaksës së gjuhës shqipe. Kshtu duhet t’jetë përkthimi”, kjo kshtu, kjo kshtu. Ajo ka qenë ni gru e vogël tha, “Erdhi duke u rrudhë, duke u rrudhë gati hyni krejt u rrudh fare. Se s’e kishte pritë kurrë se s’e kishte bo asni redaktor këto vrejte asaj”. “Prandaj”, tha, “merre”, ia ktheu përkthimin, “merre edhe rregulloj, shikoj edhe niherë se unë du t’jetë shqip dhe jo t’jenë vetëm fjalët shqip dhe t’më flas frëngjisht”.

Pastaj Enver Fico edhe ai përkthyes... si maronin ni libër ta përkthenin e kërkonin këtë t’ua redaktonte se emri ju del atyne se kjo ish redaktore, përkthyes filani domethanë. E filloj mjedisi, “Si mor’ na hyni kjo redaktorja ktu? Kjo kosovarja redaktore?” Mirëpo s’kishte burrë nane që i gjente veg se ishte ndër ma të mirat, jo ndër ma të mirat po ma e mira ishte. Që ta, t’i thojshin që ik tash largohu ose shko dikund ku di unë. Mbeti aty. A din qysh e hoqën ata? U gjet preteksti që ajo e ka burrin shkrimtar dhe kur çon burri me botu vepra kjo do ta mbaj me hatër aty dhe hajt ta çojmë në Shtëpinë Botuese të Librit Shkollor. E transferuan prej aty e çun në Librin Shkollor.

Kur shkoj atje ia dhanë librat e mjekësisë që t'i redaktonte. Kjo interesant, koincidenca. Kjo ka pasë qef shumë mjekësinë. Bile m'thoshte, "Po ta kisha studiu unë mjekësinë do të bëhesha ni mjeke shumë e shkëlqyeshme se jam shumë njerëzore. Jo mjek veç sa për ilaçe". I redaktoj atje. Profesor i shkëlqyeshëm i universitetit i anatomisë e mori... po fliste... ajo po i thotë kshtu, kshtu. I tha, "Oj Naime", Naime e ka pasë emrin, "pse s'vjen bre", tha, "ti m'i dhanë provimet te na? Po ti po i din ma mirë", tha, "sesa studentët tanë".

Pra, ishte rigoroze. Kur u kthym ktu, po marr edhe këtë shembull, e morën Revista Ekskluzive. Edhe ktu nga këta meshkujt shovinist që i ka Kosova me bollëk si të thush. "Ouu, kjo gru prej Shqipnisë", e të tjera. E morën me 600 marka rrogë. Lektore. Mirëpo kjo se dinte që ka qenë... e dinte njëni, Ramush Tahiri ndjesë pastë. Ai ishte në Shqipni ai e dinte. Ai e propozoi dhe e morën se ndryshe s'e merrnin. Ai e dinte që kush është kjo, prandaj edhe e mor'. Po këta tjerë s'dishin. Rektor zoti na rujtë. Kjo filloj jo vetëm që lektoronte ato po i mori te një për një këta redaktorët. I boni mat, a din, në shah mat, s'dinin me redaktu këta. "Ju", tha, "s'dini me redaktu lehmo të tjerat". Mbetën, s'dinin çfarë thonin.

Bile kryeredaktori i revistës e thirri ni ditë, "Naime", tha, "po ndërhyt shumë në tekst", tha, "janë anku kta". "Unë", tha, "nuk ndërhyt as nuk e vë mendjen që t'ndërhyt në tekst", tha, "po ndërhyt gjuha, unë s'kom çka boj", tha, "ndërhyt gjuha, jo unë". "Po jo", tha, ja kjo kshtu. "Shoku kryeredaktor", tha, "kjo që thoni juve është kalk serb", se ajo e dinte edhe serbishten se ka qenë thashë dy vjet në Sarajevë studente. "Është kalk serb. Na e kemi fjalën shqipe. Nuk themi e të ngjashme po themi e të tjera. Me ngjashme do të thotë kjo edhe njo që i ngjan ksaj. Kurse e tjera përveç kësaj është tjetra. Edhe kuptimi është gabim", thotë, "ti e përdor".

E kish bo ni shkrim nja ni faqe e çerek ky kryeredaktori. Tha, "Çka t'boj?" Po m'pytë mu. "Nxija", thashë, "shkruja qysh duhet m'u shkru shqip tamon". E mori e nxu krejt e shkrujt për së dyti. Çile gur gojën ma, u mbyll. Mirëpo fati i saj u sëmur me kancer dhe vdiq. Unë kom shkru ni libër me titull Herezi. Fillon fraza e parë, "Jom sëmure me kancer". E kom vizitu dhe i tham... e pastaj edhe jeta jonë pastaj aty. Është ni roman autobiografik.

Anita Susuri: Në cilin vit ka ndrru jetë?

Agim Gjakova: A?

Anita Susuri: Në cilin vit ka ndrru jetë?

Agim Gjakova: Ka vdekë në 2005-ten. Sa po bohen? 19 vjet. Edhe ajo nuk vdiq nga, kanceri nuk i preki kto organet vitale që quhen as trurin, as zemren, as mushkrinë, as mëlçinë, as veshkat. Kto që... domethanë jo. Ajo vdiq nga anoreksia. Anoreksia është kur s'han edhe dobësohesh. Nuk e donte. Filloj kimioterapinë e përjetoj randë tha, "Unë nuk boj mo. Nuk du t'vdes", tha, "disa herë du t'vdes vetëm niherë". U munosha që ta mbaj. "Ndëgjo", them... "Mos mendo që ti do t'bindem unë ty që ti t'më

mbash n'jetë mu edhe dy-tri vjet a ku po di sa mund t'kem jetë. Nëqoftëse mund t'më shërosh po, unë e sëmure nuk e du këtë jetë t'jem e sëmure as ni ditë, as ni vit", edhe e la.

Vdiq nga anoreksia nuk hongër pikë. S'pranonte as infuzione, "Nuk du". Në momentin kur u rëndu, e thirra vajzën. Vajza në Tiranë është e martune, "Hajde", thashë, "se osht' rond". Djali ishte ktu me mu. I thashë, "Unë jom dakord që t'mos e ndihmojmë ma me asgja. Që ta mbash n'jetë sa do ta mbash edhe ni muj? Tri javë? Pesë javë? Gjashtë javë? Dy muj? Po marr si shembull se ma shpejt mund të shkoj", thashë, "prandaj ju fmitë ju duhet të vendosni. Ky është propozimi im". "Mirë babë", thanë, "po e shohim".

Ajo... nipi im ishte dymbëdhjetë vjeç. Unë zbrita poshtë ishte vajza atje lart, banojshim dy katëshe në Sofali. Po vjen ajo e vogla vajza katër vjeçe. "O' gjysh hajde gjysh", tha, "se Edoni po qan". Ai ishte ulë te shtrati afër ksaj, e shihte, në kllapi ishte. Mirëpo kjo e ka rritë në Tiranë kur ishim në Tiranë. Vajza e martune. Vajza n'punë e tjera e tjera kjo e ka rritë fminë. Nuk e çum as në kopsht as në çerdhe e rriti ajo pak punë në pension te dy. Kshtuqë ai ishte lidhë jashtëzakonisht me gjyshen. Shkoj unë, "Hajde Edon", thashë, "zbrit poshtë". Kshtuqë jetoje dhe nja pesë ditë masandej vdiq, dha shpirt s'kish ma jetë.

Pjesa e Tetë

Anita Susuri: Deshta edhe me ju pytë pak për pjesën kur ka ndodhë për shembull demonstrata '81-ten në Kosovë ose ngjarjet kshtu që ka pasë në Kosovë si janë transmetu atje?

Agim Gjakova: '81-shi nuk ka pasën nifar' kushedi çfarë reagim. Nejse, meqë u vendos regjimi ushtarak në Kosovë mas '81-shit pati ato, dihet kundërshtimet e të tjera e të tjera. Po ka pasë edhe budallë të tillë, ky oficeri që të thashë, "Hajde more", tha, "hajde more", tha, "çka ke?" Tha, "Çfarë oficera kemi", tha, "ktu në ministri". "He mor' çfarë oficera ke?", thashë, "ti i ke marrë". "Jo", tha, "si kom marrë unë". A din çka më tha njëni, "Mirë mirë", tha, "që u bon demonstratat", tha, "po u prish", tha, "festa e proletariatit jugosllav". Qy çfarë hajvani (qeshë). "U prish", tha, "festa. Shqiptartë demostronin për ashtu...

E vërteta osht' që nuk folën shumë këta sepse erdh vlerësimi i njerëzve të logjikshëm dhe ata që duan, jo ata që e bon se ata hala vazhdojnë me thanë kemi bo mirë. Është bërë në histori ai quhet gabim. Pse quhet gabim? Sepse kërkesat u bon në mënyrë krejt të parakohshme edhe me ashtu... ajo u përgadit ndoshta po them unë për gojën teme. Më vjen ni shok nga Peja, bile ka bo maturë me time shoqe bashkë. "Baca Agim", tha, "kanë ardhë ni grup studentësh nga", dhetor, dhetor '80-ta, "ni grup studentësh nga Universiteti i Prishtinës", tha, "dhe unë s'di me ju dhanë përgjigje po hajde ti".

Shkoj, “He mor’ djem, çka doni?” Tha, “Baca Agim”, tha, “ke me ni se çka kemi me bo na”, “Po çka keni me bo?” “Do ta bojmë”, tha, “do ta tundim”, “Ndëgjo”, i thashë... e mora me mend që është politikisht se u bo ‘68-ta ishin procese gjyqësore të grupeve Marksiste Lininiste që i zbuluan e të tjera e tjera. “Do t’ju them”, thashë, “djem ni proverb arab që thotë para se të hysh diku mendo si ke me dalë, se mund t’hysh kollaj po si ke me dalë a mund të dalësh? Prandaj edhe ju para se me bo diçka mendoni se çfarë pasoja, qysh do ketë ajo”.

Me ata që i njihsha nuk e di a ke ndëgju ose mund t’kesh njoftë, Shaqir Shaqiri profesor i anglishtes ka maru për anglisht ka doktoru me Edi Duramin. Ky po m’thotë, kshtu, kshtu kshtu. “Shaqir”, i thosha, “kur të kthehesh paske me hy n’burg”. “Qysh bre Baca Agim ka me hy n’burg?” Tha, “Kto që m’i the ti mu krejt i di UDBA”, “Jo”, “Përgaditu”, thashë, “se ke me hy n’burg”. U kthy Shqiri e futën n’burg kllap {onomotope} atje. Unë i disha kto marifete se boheshin... bile i pata thanë edhe njo në Gjermani po ata s’mujtën me shti në burg se ishte në Gjermani.

Tha kshtu kshtu, “Uuuu”, {onomotope} thashë, “ju po fleni pa mlu, cullak natën”, “Qysh”, tha, “po thu Baca Agim”, “Qito”, thashë, “që po m’i thu ti”, se ishte një ndër ata që organizonte demonstrata në atë kohë viteve ‘70-të nëpër Gjermani e nëpër Europë. Mas gjashtë mujve m’ja çu fjalë, “Po valla kishe pasë plotësisht të drejtë se krejt...” pra, Shaqiri kur e takum, “Ha Shaqir?” Erdhi masanej vitin ‘90-të, kishte marrë Ibrahim Rugova kur shkonte në Amerikë se për anglisht si përkthyes. “E”, thashë, “Shaqir”, “Po more më futen në burg”. E kishin dënu nja ni vit e s’di sa, ku di unë në atë kohë. Se u bo pak ‘90-ta ishte pak ma ashtu.

Pra, ‘81-shi meqë ishte përzi edhe sigurimi i shtetit se kishin fut marksista lininista e tjera... në ni kohë kur në ‘68-ten e kundërshtuan republikën, në ‘81-shin doli Shqipëria me kërku republikën. Kur dihej që politika ndërkombëtare ishte totalisht n’disfavor, kur situata ishte totalisht në disfavor... po pse pikërisht, pikërisht nëpërmjet kërkesës republike me e mohu, me fshi nga rendi i ditës këtë çështje. Prandaj, kemi qenë kundër, kundër ksaj lëvizje. Nuk po thom... u bo 2004-ta ktu tollovia. Ata njerëzit që kanë marrë pjesë 99% hajde kundër shkive, a më kupton? Se kush e organizoj, pse e kundërshtoj ata hesap tjetër. Pra, edhe ajo.

Edhe ‘81-shi unë nuk them që shumë t’ri kanë qenë entuziast, kanë qenë krejt pjesa ma e madhe, a po merr vesh shyqyr që po bojmë për lëvizjen e tjera po jo n’atë kohë. Sikur t’vazhdonte Kosova edhe dhjetë vjet sikur n’vitet ‘70-të sot e kishim shtetin pa probleme, pa asi dhe pa fut shpritzat e sigurimit të huaj qoftë franceze qoftë dreqi qoftë i biri. Pra, ata u përgjigjen në Shqipni ashtu... fillun me nxjerrë çka thotë bota, jo çka thonë shqiptarët. Janë botu nja tre libra a katër nuk di, me shkrime të ndryshme nga artikuj që shkrinin nëpër botë për ngjarje.

Anita Susuri: Zoti Agim tash po m’intereson edhe me vdekjen e Enverit, Enver Hoxhës...

Agim Gjakova: Po.

Anita Susuri: Edhe ndryshimet që keni vrejt ju edhe që kanë ndiku në jetën sociale?

Agim Gjakova: Me vdekjen e Enverit u shprish pak ajo diktatura që ishte vendosur e hekurt. Domethanë u bo pak ma e lirë ajo. Nuk ishin mo ato arrestime të njerëzve për agjitacion e propagandë e të tjera, e të tjera. Ishin arrestime për hajdullëk e kto, korpuz delikti që thonë ato bohen gjithë botën s'bohen vetëm tek ne. U bo ni frymë pak ma ashtu, ma demokratike që thonë, ma e lehtë. Njerëzit fillun me marrë pak ma shumë frymë. Megjithatë nuk u hoq ajo se hala ishin ata po ashtu...

Ramiz Alija shkoj në New York në organizatë të Kombeve të Bashkuara në krye të delegacionit shqiptar. Çka osht' bo atje në Amerikë ka shumë supozime. Mund t'ketë taku amerikanët, mund t'jetë marrë vesh me të sepse ai dikur mbajti fjalim në byro atje ashtu dhe tha që ne jemi të detyrum që ta lshojmë, ta hapim derën për pluralizmin politik. U rrzu edhe busti i Enverit. Nuk pati... aty ktu ndonjë ashtu, jo, jo, jo kundërpërgjigje jo arrestime, jo. Ndonjë, për hesap të tyne e bon po jo kshtu. Po edhe ajo siç thuhet dokumentet duhet m'i nxjerrë tash po s'dalin hala n'shesh ato punë që u bo edhe me miratimin e tij, a din. Me fjalë tjera heshtje.

Se po donte pushteti jo ta rrxonin bustin e Enverin po as të afroheshin afër tij nuk i linte, ish hala n'takat, ish hala n'pushtet. Nejse, u rrzu u bo demokracia po m'erdh njëni i demokratëve. Tha, "Agim", tha, "a do me të tregu diçka", tha, "ti", tha, "bashkë me 28 veta keni qenë në listë të sigurimit të shtetit që t'pushkatoheshit ktu n'shesh si kundërshtar t'regjimit". Unë i thashë, "Këtë listë nuk e di", i thashë, "po i di hesapet tjera që i kom pa e i kom provu", (qeshë). Pra, i kishte përgadit... kanë qenë edhe Simon Stefani këta ishin kundër dhe kundër Ramizit, kundër kësaj fryme që ai e liroj pak. Me siguri edhe Nexhmija, Nexhmija... unë niherë i kom thanë ni kosovarit që tash ma përmendi, "Ledi Makbet", kriminele, kriminele.

Pastaj erdhi demokracia n'thojza siç thom unë, po. Demokracia u bo siç u bo. U kriju partia demokratike. Me Sali Berishën kom pi kafe nja 50 herë kur isha student edhe mjek. Malësia e Gjakovës, Gjakova këto ma një asi... dhe po m'thrret. U bo tollovia ikën këta nëpër anije, nëpër kto, rrzimi i bustit e këto dheteri. U vranë Arben Brosti në Shkodër katër veta, sigurimi i vrau. Tha, "Agim hajde, hajde", tha, "po krijojmë parti". Nuk shkova. "Po krijojmë partinë", tha. Edhe për herë t'dytë, "Hajde more hajde". Hajt thashë po shkoj niherë.

Kur shkoj ishin katër pesë veta. I gjej dy veta që njëni na kishte mbytë me estetikën e Enver Hoxhës duke shkru, tjetri ishte i biri i ni ndihmës prokurorit të shtetit dhe i zëvendës ministrës të këtij, sa ka qenë ajo, profesor universiteti mrena natës anëtarë t'partisë ishin bo demokrat. Ku janë demokratët e vërtetë ata që kanë vujtë, që kanë hangër dajakun, që kanë hangër burgjet, i kanë hangër... i thashë Salës, thashë, "Nuk vi", "Hajde hajde", sikur hajde n'dasmë. Kur thu për partinë, unë kom kriju ni parti po kom shku me programe konkrete kjo, kjo, kjo.

I thashë, “Unë kom Kosovën”, deri ‘90-’91-shin ti e ki parasysh ç’po bëhej në Kosovë po vriteshin edhe fmitë e po bëhej kijameti, beteri ktu, gjendja shumë e randë. Thashë, “Energjitë e mia do t’ia kushtoj Kosovës. Shqipëria”, thashë, “e ka ni pavarësi, kshtu t’mirë e t’keqe po e ka”, thashë, “Kosova është shumë keq, shumë randë. Prandaj energjitë e mia do t’ia kushtoj asaj”. Nuk shkova.

Po m’thoshte njëni, m’kishin pasë nxjerrë deputet në krahinën e Hasit. Unë i thashë, “Jo nuk shkoj, nuk du”. Mas do kohe po vjen njëni, “Pse bre Baca Agim nuk erdhe? Po gjithmonë na çojshin naj Vangjel naj Papapavli naj ku e di unë. Na erdh njëni”, tha, “nga anët tona, 99% të votave i ke pasë”. “Jo”, thashë, “nuk jom për ashtu po nuk isha n’gjendje t’mirë shëndetësore”. Nuk pranova të hyj në strukturë politike.

Anita Susuri: E n’vitet e ‘90-ta a tetut me ardhë në Kosovë?

Agim Gjakova: A?

Anita Susuri: Vitet e ‘90-ta a tetut me ardhë në Kosovë?

Agim Gjakova: Jo hala ishte sistemi, ishte edhe ma i keq se ma përpara. E kapi Millosheviçi n’dorë pastaj. Po doli UÇK-ja, doli kshtu... në vitin ‘98 kur u bo si para ofensivë e ikën me qindra mos me thanë me mijëra djem, erdhën djemtë e Gjakovës nja 200 e kusur. I organizova në ni brigadë, u vranë pesë djem nga ajo brigadë. Ajo është me pikëpytje qysh u vranë, tek u vranë. Qoftë gabimi i drejtuesve që demek përleshjet që u bonin n’front atje nalt. Qoftë edhe me tradhëti dreqi e di, duhet me hi m’i gjetë ato punë po {ngrit supet}.

Pra, fillova organizimin e kësaj domethanë. Bom muhabet nja 15-16 veta gjakovar, tjetër ishin kshtu këta ishin ma prijës si të thush. “Do me hy në Gjakovë? Du me hy në kufi”, hala ish pushteti i fortë. 204 mijë ushtar e polic ishin në Kosovë n’atë kohë. Ishte ni djalë shumë i mirë, u vra. Kishte ardhë student me mbiemër Qymyri. I thashë, “A din ti çka osht’ arma?” “Jo”, tha. S’kish kap armë me dorë kurrë. “Qysh do hish”, thashë, “ti pa ditë çka osht’ arma, pa ditë me përdorë taman qysh duhet? Pa e pasë? Pa u mësu me armën? Qysh do me hy ti në Kosovë?” E kundërshtova me t’madhe. “Në asni mënyrë”. “Mirë”, tha, “po shkojmë po rrijmë”.

Atje dikush i ka ngacmua, “Frikacak, tuca”, m’the e të thashë. U vranë atje dhe i qitën n’pritë nja 50 veta. U ulën me pushu diku ton naten deri kah mëngjesi. Kur u ulën me pushu i kishin nja tre prijës kallauz që i thonë malësor t’venit ata. Ata u ndan me ni qoshe andena anash diqysh. Kur, veç kur po pushonim, kur i kanë ndriku me projektor pëm {onomotope}. Krejt dritë i bon e ka kërshit mitrolozi. Aty u vranë 12 a 13 veta. Të tjerët u çun e ikën. Ishte ni Hasan Krasniqi ka firmë autobusash në Gjakovë. E kishte marrë ni plum ktu {nga koka lartë mbi kokë}. Unë thashë se u vranë këta budalltë e mi, krejt. 13 veta se aq ishin 14-15. Po jo kanë hy edhe të tjerë. Këta u vranë pesë, jo tre nga Gjakova. Dy tjerë u vranë ma vonë.

Thashë... erdhi Hasani ia kishin lidhë ktu {tek koka} po s'ia kishte prekë ashtin, vetëm ia çan lëkurën ai plumbi. "Hasan", thashë, "shyqyr që shpëtove", "Baca Agim", tha, "na u ka kujtu fjaltë e tua", tha, "po ish vonë", (qeshë), "ishte vonë", tha, "masi ka kërсит mitrolozi na janë kujtu fjaltë e tua", tha, "që na ke thanë. Kemi hy", tha, "me ni pellg uji", po ishte mars, jo mars fillim prilli, hala në Malësi ishte ftohtë, borë, a din kshtu malet. "Kemi hy në ni pellg uji ton ditën kemi nejtë, u mërdhim, u mërdhim u bom dakord me dalë se s'mujshim me duru atë ftohtë në ujë. Po durum ashtu qysh durum derisa ra nata që m'u tërhjekë m'u largu mos me na pa", tha. E qishtu.

Anita Susuri: E kur...

Agim Gjakova: Ahmet Krasniqin që e vran. Dy herë m'ka thirrë. I kishin thanë që jom... kemi bisedu gjon e gjatë. Ishte dakord plotësisht me atë. I thosha, "Ahmet kshtu siç jemi me këtë organizim me kshtu na edhe dhjetë vjet nuk e mposhtim dot Serbinë. Prandaj, këtë duhet ta kemi parasysh. A duhet luftu, a duhet përgadit, ktu jom plotësisht dakord po jo me aventura", "Jom dakord me ty Baca Agim, jom darkod darkod". Ai nuk donte... "Na do bojmë", tha, "atë që duhet me bo tashi". Dhe për mos me lanë atë që duhet me bo tashi edhe e vranë, e vranë për shumë sene.

Unë e kom prekë me dorë siç po të flas ty amerikanët. Erdhën në Shqipëri. Njëni ishte pak ma i ri se unë. Na pyeti tha, "A mundet", tha, "Maqedonia me strehu 200 deri 300 mijë shqiptarë?" Neve na u dok budallallëk kjo pyetje. Kur në Bosnje vrau 200 mijë në Kosovë do t'i vriste 500 mijë pse na ka djem t'dajës e t'hallës Millosheviçi? Mirëpo politika osht' me t'qitje t'gjatë, me ata topat, me ata dronet që shkojnë. Ata i kishin mendu, i dijshtin sendet. Edhe eksodin që ndodhi që i kishin përzan shqiptarët, e kishin planifiku të gjitha hesapet. Por nuk e donin krijimin e një ushtrie të vërtetë të Kosovës. Absolutisht asnjëni nga shtetet perëndimore.

Unë e kom realizu atë, ose inxhizo ti këtë apo p'e inxhizon? Nejse, s'prish punë se e kom thanë edhe midis... e kom realizu nuk e donin ni ushtri sepse kjo ushtri do t'ju nxirrte telashe sot. Nuk do ta lenin Thaçin me ardhë n'pushtet ksi soji, ose n'pushtet po vepro ashtu qysh duhet. Nuk e deshën. S'po flas për Francë e për këta që ishin kundër po as amerikanët. Nëqoftëse t'kujtohet... s'jom as pro amerikan as kundër amerikan. I kom thanë atij amerikani, jo, një tjetri. "Kosova osht' vend europian por nëqoftëse duhet të zgjedhim aleat unë zgjedh Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por ka një gjo", thashë, "mos mendoni se unë mund t'veproj më shumë për Amerikën dhe ta du Amerikën më shumë se Kosovën, jo".

Këta shoktë më thanë, "Prandaj ty nuk t'ofrojnë amerikanët, e me mbyll vet", "S'e kom nevojë", thashë, "as s'e kom ndërmend me shku në Amerikë". Imë bijë ka qenë një tre-katër herë në Amerikë me gjithë dhandrrin. E po m'thoshin ni ditë, "O' babë", tha, "ti tha..." se kom thanë, unë, kom shkru. Sarajeva gozhda e Nastradinit dhe kom kritiku Amerikën, forcat amerikane që e lanë Sarajevën një mijë ditë të rrethun e kanë vdekë njerëzit për bukë e tjera, nuk shkoj Amerika. Kur shkoj Miter Hani

atëherë ju kujtu hajt tha nalu nalu se varret qy. Shkun amerikanët mas një mijë ditësh. Pse e lanë Sarajevën një mijë ditë ashtu?

Në vitin '90 ka dalë ni shkrim i Institutit Ushtarak të Londrës që është instituti ma i specializun i botës i çështjes ushtarake. M'kujtohet vetëm tri variante për Jugosllavinë, mu m'kujtohet varianti i tretë që m'interesonte ma së shumti. Kto ishin njerëz ashtu... politika perëndimore do t'i lëjë Kombet e Jugosllavisë të përplasen me njëri tjetrin e të luftojnë e të bojnë dhe nga kjo përplasje nga kështu do të strukturohen kufijtë e rinjë të ish Federatës Jugosllave. Kjo ndodhi e vërteta, a u bo qashtu? Qashtu u bo. Luftoj... ne jse sllovenët nuk luftuan fort se u bo. Kroacia luftoj, Vukovari u dogj, u përly u bo betej. Ti ke qenë në Kroaci? [i referohet Ana Morinës] Ne jse ke qenë e re apo s'ke qenë n'projekt fare?

Ana Morina: Jo s'jom kanë.

Agim Gjakova: Sa vjeçe je?

Ana Morina: 25.

Agim Gjakova: As fmi s'ka qenë kjo. Po ke ndëgjju nga prindërit. E ashtu Vukovarin e tjera. Bosnja mo mos pyt çka u bo e tjera e tjera. Por, me Kosovën ka qenë ndryshe realizimi. Bushi plak në '92-shin doli tha, vu vijën e kuqe Millosheviçit. Me fjalë tjera ti gjenocide e ksi marifete në Kosovë mos bëj se nuk do të tolerohesh. Ata disa thonë, "Le bre se Millosheviçi ka qenë agjend i Amerikës". Ai edhe mund t'ketë qenë se ka punu në Amerikë disa vjet si n'bankë e tjera. Ka punu atje. Dreqi e di tash. Edhe dëbimi e tjera... dëbimi me provu, me provu lëvizjen e popullsisë, ishte edhe ni provë, ni provë. Provë taktike mos me thanë strategjike. Provë strategjike e botës.

Anita Susuri: Po m'intereson pas përfundimit të luftës që jeni kthy, qysh ka qenë për juve ajo?

Agim Gjakova: Në Shqipëri a ktu?

Anita Susuri: Kur jeni kthy ktu në '99-ten.

Agim Gjakova: E ke pa atë librin Kosova dhe shkrum është e hijshme. Aty fillon kthimi. Kur u ktheva unë pashë që asni parti s'osht' e zonja me kriju ni qeveri tamon qysh duhet. A m'kupton? Ibrahim Rugova e mblodhi Kuvendin e Kosovës të zgjedhur gjatë luftës, gjatë viteve '90-të. Jack Kovi zëvendës i Kushnerit i çoj ultimatum, "Nesër deri në orën 04:00 mas dreke të jetë abrogu kuvendi", të shpërndahet kuvendi, "të jetë abrogu posti i presidentit të Kosovës", që ishte zgjedhë Ibrahim Rugova. Ibrahim s'kishte edhe ç'të bënte, u bë kjo punë ksi soji.

U kriju KPA-ja, Këshilli i Përgjithshëm Administrativ. Midis ktyne mori pjesë edhe Rexhep Qosja që ishin dy veta n'parti (qeshë). S'kishte parti ai. Pse mori pjesë? Ne jse. Rambuje. Rambuje ka disa lshime

shumë, shumë domethanëse dhe gabime strategjike. Në Rambuje ka qenë dashtë këta delegacionet kur osht' diskutu atje edhe për kufitë t'i diskutonin kufitë natyror të shqiptarëve dhe t'i thonin që ne shqiptarët që jemi deri afër Nishit dhe tokat tona. Kjo as që u përmend fare. Ky ka qenë gabim.

Pytja e parë vjen a do vendosej? Jo, dihej. Na kemi diskutu në Tiranë me njerëz që duhej. Nuk do vendosej se politika nuk do ta lejonte atë por do mbeteshin si tash ky Vuçiqi që t'i nxjerrë tash përpara që kjo, që kjo, që kjo. Do mbetesh që kjo dhe kjo, do t'i thuash edhe ti politikës ndërkombëtare që kjo osht'. Nuk u bo ajo punë. Masanej ka ni fakt. Presheva, Bujanoci, Medvegja deri në vitin 1946 kanë qenë mrena Kosovës. Nuk e di a e dini këtë. Serbia i hoqi kto, i çoj në Serbi i bashkoi, i shkëputi dhe ia bashkangjiti Leposaviçin me serb. Që me ndryshu strukturën nacionale të Kosovës. Pra, e kom fjalën... Nejse kto janë...

E dyta me intuitën time politike në Kosovë u vendos pushteti i argatëve të shërbimeve të huja. Në fillim këta shoktë e mi nuk ma kanë pranë këtë. Ma vonë duke i pa zhvillimet e tjera m'thanë, "Ke pasë plotësisht të drejtë". Pushteti i argatëve të shërbimeve t'huja. A ndëgjohet këtu n'dhomë a nuk dëgjohet? A keni ndonjë ashtu nga SHIK-u?

Anita Susuri: Sekret i joni është (qeshë).

Agim Gjakova: Sekret i juji? Nejse megjithatë unë po e them.

Anita Susuri: Jo, jo.

Agim Gjakova: Cila është inteligjenca jonë këtu në Kosovë?

Anita Susuri: Inteligjenca e shtetit a?

Agim Gjakova: Po de, shërbimi i zbulimit sekret cila është? Qysh është? E di ti?

Anita Susuri: Jo.

Agim Gjakova: Jo nuk e di. Inteligjenca jonë është në pesë pjesë. Amerikanët, anglezët, francezët, gjermanët edhe turqit.

Anita Susuri: E pse ashtu?

Agim Gjakova: Në vitet 2000 e diçka s'po m'kujtohet tashi, s'ka rëndësi ose edhe më vonë nashta, jo më vonë. Në Kosovë janë përgju, ka pasë 60 mijë përgjime. A e din ti këta? Jo. 60 mijë përgjime e kom qenë edhe unë natyrisht. Bile jo ni shërbim po disa. Bile e kapa njënin që po m'përgjonte telefonin

edhe e zura. “Ha mor”, thashë, “po m’përgjon a?” “Po valla e kom për detyrë”. Se e zuna keq, ngusht. Shqiptarë kush e di i kanë thanë.

Thashë, “Unë jom person publik, merre shtypin gazetën ku kom punu unë Bota Sot, i ke duke fillu prej Thaçit dy shkrime i ka Hashim Thaçi në vorbull. Hashim Thaçi përsëri”... vorbull i thonin shtjellë uji, “në vorbull politike që është”. Unë nuk kom sha, nuk fyt askënd. I kom mbi 900 faqe analiza politiko-kulturore shoqërore. Ama me i thanë sene t’vërteta. Po m’thoshte, “Shkruj ni shkrim sikur të ishte gjallë Faik Konica”, me këtë titull dhe citoj Faik Konicën. Në rast se Shqipëria, vizë fjalë e randë, vdes atëherë mbi gur të varrit t’saj duhet të shkrujmë. E ngjallën idalistët, e shpëtuan rastët dhe e vranë politikanët.

A vlen kjo edhe për Kosovën? E t’ju hi hu ktyne pa sharja, pa fyrtje. I ndjeri Ali Podrimja ishte gjallë e vjen shumë i shqetësuar. Atëherë po boheshin vrasje politike. U bon mbi 600 vrasje politike, se di a dini a s’e dini, a ju kanë thanë? Nejse, s’ka rëndësi. Shumë i shqetësuar. “Ndëgjo”, thashë, “Ali, unë kom kalu periudha që kom pa vdekjen me sy disa herë aty. Unë këtu ajo aty rrinte. Prandaj”, thashë, m’fal për shprehjen, “për këta qena s’pys fare”. I kom thanë. Kto i kom thanë. Kosovën janë duke e vranë dalë nga dalë politikanët. Sikur t’mos nënshkruhej, t’mos krijohet ai i ashtu quajtur asociacion sot nuk do t’kishte telashe Kosova. Mund t’kërkonte Vuçiqi çkado po punë e madhe. Se t’ze ngusht.

Ti a shikon Borelli anti kosovar, Lajçak anti kosovar pavarësisht se dalin gjoja liberal, gjoja të drejtën m’the e të thashë. Sjelljet e tyne, qëndrimet e tyne... nuk po themi që edhe politika amerikane është duke përkëdhel Serbinë për interesa të caktune, me mujtë e me shkëputë nga Rusia. E gjitha kjo është me mujtë me i shkëputë nga Rusia. Edhe neve na thonë, “Mirë mirë ne jemi me ju po tashi Serbia është ksi soji”. Demek duhet me nguc Serbinë. Derisa të nguci ty Serbia në Banjë. E nesër të nguc prap.

Anita Susuri: Zoti Agim, faleminderit...

Agim Gjakova: Unë e krijova, nisëm me kriju ni parti mirëpo e pashë që osht’ e pamundur sepse shkoj unë atje te Dan Eversi ishte i OSBE-së, në vitet 2000. E ndriti Shqipërinë, erdhi me ndritë Kosovën. Me çu në pus. Isha ni ndihmës i tij, u hongër me fjalë, ai s’më përballoj dot tha, “Unë s’i kom n’dorë”, tha, “kto sene i ka Dan Eversi”. Po i thom ni djali aty punonte në OSBE, “Ha mor” thashë, “se ti i din këto sene”, tha, “Baca Agim”, tha, “unë ktu jom për mos me ditë”. Me fjalë tjera nuk m’len kurgjo m’u përzi e të tjera. Siç të thashë... sa shkoj sahati? {shikon orën} pasna mbajtë boll.

Siç të thashë politika e argatëve të shërbimeve të huja... unë i di disa, ndëgjo duke qenë se unë isha jo objekt po edhe subjekt i sigurimit të shtetit kanë pasë këta të sigurimit që e krijuan masanej idenë e vartësisë time dhe të integritetit tem dhe m’kanë thanë disa sene. M’kanë thanë, “A e njef”, filanin? “Po”. “Ky e ka nënshkru”, tha, “bashkëpunimin me UDB-në në Mal të Zi”, tha, “në Andrijeviç”. Ky kshtu, ky kshtu i disha disa sene. Masanej e pys edhe këta që ishin të UDB-së të Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Kosovës. S’kishin qare pa m’i thanë mu. S’kishin qare sepse unë i kom njoftë që atëherë.

Muharrem Dana vdiq i shkreti. E pys për tre veta. “Agim”, tha, “mos më pyt për këta. Pytëm për naj tjetër”, tha... sepse ka qenë ni shërbim në Beograd ku ne nuk kemi pasë qasje. Tha, “Shko pyti ata, ata e dijnë ku i kanë çu këta nëpër botë me prish ujn, me tollovitë”. Kshtuqë unë fillova me punu në gazetë Bota Sot. Nuk dishin çka domethanë redakturë. Më thirri ai budalla, biznesmeni tha, “A po bohesh drejtor?” “Hajt”, thashë, “po bohna drejtor”.

Nuk e kom qef, nja tetë muj u bona drejtor i gazetës ktu. I vuna në vijë disa sene, disa rubrika, disa të tjera e të tjera. Pastaj, u prisha me të. Ai fuste pa marrë vesh çka osht’ shtypi fuste gjithçka dur e krye me ner’ me thanë, prapanicë e. “Ik mor” thashë, “se nuk bohet kshtu”. Ika e lashë dola në pension. Krijova PENIN që të thashë.

Anita Susuri: Mirë, zoti Agim ju kisha falënderu shumë për intervistën, për kohën ishte knaqësi.

Agim Gjakova: Ju kom mbyttë me prralla juve.

Anita Susuri: Jo, tamon puna.

Agim Gjakova: A?

Anita Susuri: Jo, jo.

Agim Gjakova: Mirë.